

KEIGO HIGASHINO
KRIMI I PËRKRYER
ROMAN

BOTIMET TOENA

KEIGO HIGASHINO

KRIMI I PËRKRYER

roman

Përktheu: Bisej Kapo

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2020

Autori: Keigo Higashino
Titulli në origjinal: Seijo no Kyusai
Botimi në origjinal i publikuar nga Bungeishunju Ltd., Japoni në vitin 2008.

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo
Redaktore: Anrila Spahija
Korrektore letrare: Petrina Ago
Përkujdesja grafike: Elsa Hajderaj
Kopertina: Mirjana Madhi

ISBN 978-9928-327-15-4

© 2008 HIGASHINO Keigo

© *në shqip* Botimet Toena,

sipas licensës së dhënë nga Keigo Higashino, Japoni, dhe marrëveshjes me Bungeishunju L.td., Japoni, përmes Japan UNI Agency, Inc., Japoni.

Seijo no Kyusai by HIGASHINO Keigo

Copyright © 2008 HIGASHINO Keigo

All rights reserved.

Original Japanese edition published by Bungeishunju Ltd., Japan in 2008.

Albanian translation rights in Albania reserved by Botimet Toena,

under the license granted by HIGASHINO Keigo, Japan,

arranged with Bungeishunju Ltd., Japan through Japan UNI Agency, Inc., Japan.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

www.toena.com.al

Një

Vjollcat në vazo kishin çelur lule të vogla, shumë-
ngjyrëshe. Dheu i tharë nuk dukej se ua kishte zbehur ngjyrën
petaleve. *Ndoshta nuk bien shumë në sy, por i bëjnë ballë të
ftohtit gjatë*, - mendoi Ajane, duke parë verandën përtej derës
rrëshqitëse prej xhami. - *Duhet t'i ujis sapo të mundem.*

- E dëgjove se ç'thashë? - pyeti Joshitaka.

Ajane u kthye dhe i buzëqeshi lehtë.

- Po, sigurisht që të dëgjova.

- Atëherë bëj një përpjekje për t'u përgjigjur.

Joshitaka, i ulur në divan, shtriqi këmbët e gjata dhe
i vendosi sërish njëra mbi tjetrën. Gjatë stërvitjeve të tij
të shpeshta bënte kujdes të mos t'i forconte më shumë se
ç'duhej gjymtyrët e poshtme: e kishte ende me qejf t'i vishte
pantallonat e tij elegante dhe të ngushta.

- U hutova pak.

- Oh?! Nuk para e bën.

I shoqi ngriti vetullën përpjetë.

- Ta dish se ajo që më the më befasoi vërtet.

- Si është e mundur?! Tashmë duhet ta dije se ç'dua nga
jeta.

- Po... Duhet ta dija.

- Çfarë do të thuash?

Joshitaka u mbështet i shpenguar në divan duke zgjatur krahët prapa mbështetëses. Ajane pyeti veten nëse ai po tallej, apo ishte vërtetë kaq indiferent.

Mori frymë dhe vështroi fytyrën e bukur të të shoqit.

- Është shumë e rëndësishme për ty? - e pyeti.

- Çfarë?

- Të kesh fëmijë.

Joshitaka bëri një ngërdheshje përçmuese dhe ironike. Largoi shikimin, pastaj u përqendrua sërish tek ajo.

- Domethënë, nuk më paske dëgjuar?

- Të dëgjova, - tha Ajane me një vështrim të zemëruar, duke shpresuar se ai do ta vinte re. - Për këtë arsye po të pyes.

Buzëqeshja u zhduk nga fytyra e Joshitakës teksa pohoi ngadalë.

- Po. Është e rëndësishme. Shumë e rëndësishme. Madje, thelbësore. Nëse nuk mund të kemi fëmijë, nuk ka kuptim martesë jonë. Dashuria romantike herët a vonë mbaron. Njerëzit jetojnë bashkë për të ndërtuar familje. Një burrë dhe një grua martohen, bëhen bashkëshortë, më pas bëjnë fëmijë dhe bëhen prindër. Vetëm atëherë do të jenë shokë jete në kuptimin e vërtetë të fjalës. A nuk je dakord?

- Besoj se martesë nuk është vetëm kaq.

Joshitaka tundi kokën.

- Për mua po. Jam i bindur dhe ngulmoj në idenë time. Kjo do të thotë se nuk kam ndër mend të vazhdoj në këtë mënyrë, nëse nuk mund të kemi fëmijë.

Ajane shtypi tëmthat me gishtërinj. Kishte dhimbje koke. Ato fjalë e gjetën të papërgatitur.

- Lërmë të kuptoj, - tha. - Nuk të hyn aspak në punë një grua që nuk bën dot fëmijë. Ndaj, do të më lësh dhe të gjesh një tjetër? Këtë po më thua?

- Nuk është rasti që ta interpretosh kështu.

- Por, këtë po më thua!

Joshitaka u drejtua. Nguroi për një moment, fytyra iu ngrys përpara se të pohonte sërish.

- Po, mendoj se kështu është, parë nga pikëpamja jote. Por duhet të kuptosh që kam projekte shumë serioze për të ardhmen time. Dhe këtë gjë e kam më të rëndësishmen nga të gjitha.

Buzët e Ajanes u nderën në një buzëqeshje; edhe pse të buzëqeshte ishte gjëja e fundit që do të donte të bënte.

- Të pëlqen t'u thuash njerëzve kështu, apo jo? Që kë projekte të mëdha për të ardhmen. Është një nga gjërat e para që më ke thënë kur u njohëm.

- Pse po e zgjat kaq shumë, Ajane? Ke gjithçka që ke dashur gjithmonë. Nëse kam harruar ndonjë gjë, mjafton të më thuash. Do të bëj gjithçka për ty. Ta mbyllim këtë bisedë dhe të fillojmë të mendojmë për të ardhmen. Apo ke ndonjë zgjidhje tjetër?

Ajane u kthye. Shikimi i shkoi te një sixhade e varur në mur. I ishin dashur tre muaj ta bënte: i kujtohej pëlhura, të cilën e kishte porositur posaçërisht në Angli.

Nuk ishte e nevojshme që Joshitaka t'i thoshte se sa të rëndësishëm ishin fëmijët. Edhe ajo i kishte dëshiruar çmendurisht. Sa herë e kishte ëndërruar veten tek ulej në një karrige lëkundëse të qepte një jorgan *patchwork* dhe të shihte barkun tek rritej dita-ditës? Por Zoti po ia mohonte për ta ndëshkuar. Duke mos pasur asnjë zgjidhje tjetër, Ajane ishte dorëzuar. Besonte se edhe i shoqi e kishte ndarë mendjen tashmë.

- E di që mund të duket budallallëk, por a mund të të bëj një pyetje?

- Sigurisht.

Ajane u kthye sërish drejt tij dhe mori frymë thellë.

- Po dashuria që ke për mua, ku shkoi?

Joshitaka u tërhoq, pastaj gradualisht filloi të buzëqeshte.

- Dashuria ime për ty nuk ka ndryshuar, - tha. - Të jesh e bindur. Unë të dua akoma.

Ajane e dinte që ishte gënjeshtër, por buzëqeshi dhe u shtir e lehtësuar. Nuk dinte ç'të thoshte më.

- Shkojmë.

Joshitaka u ngrit dhe u drejtua për nga dera.

Ajane i hodhi një sy komosë dhe u kujtua për pluhurin e bardhë të fshehur brenda një qeseje në sirtarin e fundit djathtas.

Më duket se do ta përdor së shpejti, - mendoi, ndërkohë që rrezja e fundit e shpresës fundosej në errësirën e zemrës së saj.

Duke dalë vështroi shpinën e të shoqit: Të dua më shumë se çdo gjë tjetër në botë. Për këtë arsye fjalët e tua më goditën në zemër, - mendoi. - Dhe për këtë arsye duhet të vdesësh edhe ti.

Dy

Hiromi Uakajama filloi të dyshonte disi kur pa Mashibat tek zbrisnin shkallët. Buzëqeshjet e tyre ishin të sforcuara, sidomos ajo e Ajanës.

- Na fal që të lamë të prisje, - tha Joshitaka. Më pas, paksa ashpër, e pyeti nëse kishte ndonjë lajm nga Ikait.

- Jukiko sapo më dërgoi një mesazh, ku më thoshte se do të mbërrinë pas pesë minutash, - u përgjigj Hiromi.

- Atëherë po shkoj të marr shampanjën.

- Jo, shkoj unë, - këmbënguli Ajane. - Hiromi, a mund t'i marrësh gotat?

- Sigurisht.

Hiromi pa Ajanen të zhdukej në kuzhinë, para se ajo të afrohej te bufeja e lartë, që ndodhej në dhomën e ngrënies. Ishte një mobilie antike që kishte kushtuar, në mos gabohej, tre milionë jen. Edhe gotat brenda saj ishin të shtrenjta.

Me kujdes të madh mori pesë gota shampanje: dy *baccarat* dhe tri të stilit venecian. Mashibat e kishin për zakon të përdornin gota të stilit venecian me miqtë e tyre.

Joshitaka po vendoste me kujdes pesë peceta në tavolinë. Dinte se si të organizonte një darkë, dhe Hiromi kishte mësuar me kalimin e kohës.

Vuri nga një gotë shampanje në secilin vend. Dëgjoi një gurgullimë uji në kuzhinë. Iu afrua Joshitakës.

- I the gjë? - pëshpëriti.
- Jo ndonjë gjë kushedi se çfarë, - u përgjigj ai pa e ngritur shikimin.

- Por biseduat, apo jo?
Joshitaka e vështroi ngulazi.

- Për çfarë?

Për çfarë?! - u bë gati të pyeste ajo, por u ndërpre nga trokitja e derës.

- Mbërritën! - thirri Joshitaka nga kuzhina.

- Më fal, i kam duart e zëna. A mund ta hapësh ti? - iu përgjigj Ajane.

- Sigurisht, - tha Joshitaka dhe shkoi ta hapte derën.

Dhjetë minuta më pas, miqtë dhe të zotët e shtëpisë ishin të ulur në tavolinë. Qeshnin të gjithë, edhe pse në të vërtetë Hiromi perceptonte një sforcim, sikur po përpiqeshin të ishin në humor të mirë me çdo kusht. Pyeste veten sesi ia dilnin njerëzit të shtireshin. Sigurisht që nuk ishte një aftësi e lindur: Hiromi e dinte që Ajanes i ishte dashur të paktën një vit për t'u përshtatur me atë lloj situatë.

- Ti Ajane gatuan gjithmonë gjëra të shijshme, - vuri në dukje Jukiko Ikai, ndërkohë që hante peshk të bardhë. - Nuk ndodh shpesh që një peshk i marinuar të jetë bërë me kaq kujdes.

Jukiko kishte zakon të lavdëronte çdo pjatë gjatë darkave.

- E po, e besoj që të pëlqen! - komentoi i shoqi, Tatsuhiko, i ulur pranë saj. - Ti përdor vetëm paketimet me salca të gatshme.

- Ndonjëherë e përgatis edhe vetë.

- Ndoshta salcën *aojiso*, atë me shije mente.

- E, pastaj? Është e mirë!

- Mua nuk më duket e keqe *aojiso*, - ndërhyri Ajane.

- E sheh? Madje është e shëndetshme, - tha Jukiko duke buzëqeshur.

- Të lutem, Ajane, mos ia zgjat, - murmuriti Tatsuhiko, - përndryshe do të lyejë edhe biftekun tim me atë salcë.

- Aha, sa ide e mirë! Herën tjetër do ta provoj këtë, - tha Jukiko.

Qeshën të gjithë, përveç Tatsuhikos.

Tatsuhiko Ikai, avokat, punonte si konsulent ligjor për shumë shoqëri, mes tyre edhe ajo e Joshitaka Mashibës, për të cilën kishte edhe detyra të rëndësishme administrative. Ata të dy ishin miq që nga koha e universitetit.

Tatsuhiko mori një shishe verë dhe i shërbeu Hiromit.

- Oh, faleminderit, mjafton! - iu përgjigj ajo duke venë dorën mbi gotë.

- Vërtet? Mendoja se të pëlqente vera e bardhë, Hiromi.

- Oh, po, kam pirë mjaftueshëm! Faleminderit!

Tatsuhiko hoqi dorë, pastaj mbushi gotën e Joshitakës.

- S'ndihesh mirë? - pyeti Ajane.

- Jo, jam mirë, vërtet. Vetëm se në këtë periudhë kam dalë shpesh për të pirë dhe nuk dua ta teproj.

- Ah, të jesh i ri e të bësh festa gjithmonë! - tha Tatsuhiko duke i hedhur verë Ajanës, para se t'i hidhte një vështrim të shoqes dhe ta afronte shishen pranë gotës së tij. - Jukiko nuk mund të pijë alkool për ca kohë, kështu që më takon të pi vetëm.

- Eh, sigurisht, - tha Jukiko me pirunin e ngritur në ajër, - mendoj se nuk më lejohet, apo jo?

- Vetëm nëse do të pish për dy! - tha Tatsuhiko, duke rrotulluar lehtësisht verën në gotë. - Në fund të fundit, gjithçka që ha përfundon në qumësht.

- Kur mund të fillosh të pish? - e pyeti Joshitaka.

- Doktori thotë pas një viti.

- Një vit e gjysmë, - tha i shoqi. - Edhe dy nuk do të të bënin keq. Por, në këtë pikë, më mirë ta lësh përgjithmonë.

- Pra, duhet të kujdesem për fëmijën dhe mos të pi asnjë pikë për disa kohë? As që bëhet fjalë! Vetëm nëse ti ke ndër mend të merresh me princin tonë të vogël. Në atë rast edhe mund ta mendoj.

- Dakord, dakord, - i ra për shkurt i shoqi, - por prit të paktën një vit. Dhe gjithsesi, edhe në vazhdim, mos e tepro...

Jukiko e vështroi vëngër, por filloi të qeshte menjëherë. Sikur këto zënka të vogla bashkëshortore të ishin pjesë e një rituali, që në të vërtetë e mirëpriste.

Jukiko Ikai kishte lindur dy muaj më parë. Ishte fëmija i parë dhe i shumëpritur prej kohësh. Tatsuhiko ishte dyzet e dy vjeç dhe Jukiko tridhjetë e pesë. Flisnin përzemërsisht për atë shtatzëni, si një gol i shënuar në minutën e fundit.

Darka ishte një lloj feste, ndonëse e vonuar, për lindjen e të voglit. Ishte një ide e Joshitakës, dhe Ajane kishte bërë përgatitjet e nevojshme.

- Pra, sot i vogli është te prindërit e tu? - pyeti Joshitaka. Tatsuhiko pohoi.

- Po. Na thanë të mos shqetësoheshim për orarin, dhe se mezi prisnin të kujdeseshin sërish për të sapolindurin. Ndonjëherë është fat që prindërit banojnë afër teje.

- Edhe pse, me thënë të drejtën, jam pak e shqetësuar, - pranoi Jukiko. - Mamaja jote i jep shumë vëmendje, nuk di në jam e qartë. Një mikeshë ime thotë se është më mirë t'i lësh të qajnë pak në fillim para se t'i marrësh në krahë.

Hiromi u ngrit nga karrigia, pasi vuri re që Jukiko e kishte gotën bosh.

- Po shkoj të të marr ujë.

- Ka një shishe me ujë mineral në frigorifer, sille këtu, - i tha Ajane.

Hiromi shkoi në kuzhinë dhe hapi frigoriferin e madh, me dy dyer në qendër. Njëra anë ishte plot me shishe uji mineral. Hiromi mori një dhe u kthye në tavolinë. Sytë iu shkëmbyen me ato të Ajanës, që i shprehu mirënjohjen e saj.

- Më duket se të kesh një fëmijë të ndryshon jetën, - po thoshte Joshitaka.

- Me siguri jeta e përditshme fillon të vërtitet rreth të voglit, - u përgjigj Tatsuhiko.

- Ma merr mendja. Por, a ndikon kjo edhe në punë? Thonë se të kesh fëmijë rrit ndjenjën e përgjegjësisë. Si mendon? A punon më shumë tani që je baba?

- Eh, në të vërtetë po!

Ajane mori shishen e ujit nga Hiromi dhe, me buzëqeshje në buzë, ia mbushi gotën gjithsecilit.

- Meqë ra fjala, tani ju takon juve, apo jo? - tha Tatsuhiko, duke parë herë Joshitakan e herë Ajanen. - Sa keni që jeni të martuar tashmë, një vit? Nuk u mërzitët akoma duke u sjellë si të sapomartuar?

- Shpirt, - ndërhyri Jukiko dhe e goditi në krah të shoqin, - po fut hundët...

- Dakord, dakord, - tha Tatsuhiko me një të qeshur të sforcuar. - Secili të vetën, mendoj.

Rrëkëlleu verën e mbetur dhe zhvendosi shikimin te Hiromi.

- Po ti? Mos u shqetëso, - ngriti njërën dorë, - nuk do të bëj pyetje pa vend për një beqare. Do të të pyesja vetëm se si shkon në shkollë. Gjithçka mirë?

- Deri tani po. Por ka ende shumë për të mësuar.

- Eh, ke mësuesen më të mirë që mund të gjendet, - tha Jukiko.

U kthye nga Ajane.

- Po lë gjithçka në dorë të Hiromit?

Ajane pohoi.

- Kam frikë se tashmë i kam mësuar gjithçka që di.

- Eh, është fantastike! - tha Jukiko.

Hiromi buzëqeshi përzemërsisht dhe uli shikimin. Ishte e bindur se Ikaive nuk u interesonte shumë se me çfarë merrej. Po kërkonin vetëm ta përfshinin në bisedë, që të mos ndihej e përjashtuar në një tavolinë me dy çifte.

- Meqë ra fjala, - tha Ajane duke u ngritur, - kam një dhuratë për ju.

Shkoi të merrte një çantë kartoni pas divanit dhe e solli në tavolinë.

Kur pa ç'ishte, Jukiko ia dha një britme të tepruar habie, duke mbuluar gojën me duar. Ishte një jorgan *patchwork*, i punuar me delikatesë, por më i vogël se zakonisht.

- Mendova se mund ta përdornit për shtratin e të voglit, - tha Ajane. - Dhe kur të jetë rritur, mund ta varni në mur.

- Oh, është shumë i bukur! - tha Jukiko me një buzëqeshje të theksuar. - Shumë faleminderit, Ajane!

Shtrëngoi buzën e jorganit me një dorë, duke vlerësuar përmbajtjen e pëlhurës.

- Jam e sigurt se do t'i pëlqejë shumë. Faleminderit!

- Kjo po që është dhuratë. Besoj të është dashur shumë kohë për ta përgatitur, apo jo? - pyeti Tatsihuko, duke parë Hiromin në kërkim të një pohimi prej saj.

- Sa kohë të ka marrë? Gjashtë muaj, ndoshta? - pyeti Hiromi Ajanen.

Ajane rrudhi vetullat.

- Nuk më kujtohet saktësisht... - iu përgjigj, pastaj u kthye nga Jukiko, - por jam e kënaqur që të pëlqen!

- Oh, e adhuroj! - tha Jukiko. - Por nuk di në mund ta pranoj. Shpirt, a e di sa kushton një gjë e tillë? Një mbulesë shtrati origjinale nga Ajane Mita vlen një milion jen në galerinë e Ginzas.

- Uau! - thirri Tatsuhiko, duke zgurdulluar sytë dhe duke u befusuar që disa copa stofi të qepura bashkë mund të kushtonin kaq shumë.

- Sinqerisht nuk e kam parë të punojë me kaq shumë pasion në asnjë nga jorganët e saj deri më tani, - tha Joshitaka. - Rrinte aty e ulur, duke qepur në atë divan edhe gjatë ditëve që isha i lirë. Ndonjëherë nuk ndalonte fare. Më bënte shumë përshtypje.

- Mbi të gjitha e mbarova në kohë, - vuri në dukje me qetësi Ajane.

Pas darkës grupi u zhvendos në sallon, ku burrat njoftuan se do të pinin uiski. Jukiko pyeti nëse mund të kishte një kafë, dhe kështu Hiromi u drejtua për nga kuzhina.

- Oh, merrem unë, - tha Ajane. - Pse nuk merrni gotat e ujit për uiski? Në frigorifer ka akull. Ajane shkoi te çezma dhe mbushi ibrikun.

Kur Hiromi u kthye në sallon, biseda ishte zhvendosur te kopshtaria. Në kopshtin e Mashibave kishte shumë drita për ambientin e jashtëm; ishin vendosur në mënyrë të tillë që lulet dhe bimët, edhe në mbrëmje, të spikasin.

- Duhet të kërkojë shumë përkushtim të kujdesesh për gjithë këto bimë, - tha Tatsuhiko.

- Unë i lë pak mënjane detajet, - iu përgjigj Joshitaka, - por Ajane kujdeset për to në mënyrë të vazhdueshme. Ka të tjera edhe në tarracën e katit të parë. I ujit çdo ditë. Unë nuk

do t'ia dilja dot, por asaj nuk i peshon kjo gjë. I adhuron lulet e saj.

Hiromi kishte përshtypjen se Joshitakës nuk i interesonte argumenti: e dinte që ishte indiferent ndaj natyrës.

Ajane u kthye nga kuzhina me tre filxhanë kafeje. Meqë iu kujtua uiski, Hiromi shpejtoi të hidhte ujë në dy gota.

Kishte kaluar ora njëmbëdhjetë kur Ikait pohuan se duhet të ktheheshin në shtëpi.

- Ishte një darkë e bukur. Dhe çfarë dhurate! - tha Tatsuhiko duke u ngritur. - Herën tjetër duhet të vini nga ne. Por, ju paralajmëroj: duke marrë parasysht fëmijën dhe gjithçka tjetër, mbretëron një rrëmujë e madhe.

- Do shoh se ç'mund të rregulloj, - tha Jukiko duke e goditur lehtë gjoksin e të shoqit përpara se t'i buzëqeshte Ajanes. Duhet të vini të shihni princin tonë të vogël, që ngjan si një engjëll topolak.

Ajane e siguroi se do të shkonte patjetër.

Edhe për Hiromin erdhi ora për t'u kthyer në shtëpi, prandaj tha se do të dilte bashkë me Ikait. Tatsuhiko i ofroi ta shoqëronin me taksi deri tek apartamenti.

- Ah, Hiromi, nesër nuk do të vij, - e informoi Ajane vajzën, ndërkohë që po vishte këpucët te hyrja.

- Harrova, kjo fundjavë është e gjatë. Do të shkosh gjëkund? - pyeti Jukiko.

- Do të shkoj të vizitoj prindërit e mi.

- Në Saporu?

Ajane pohoi, duke buzëqeshur.

- Po, babai im nuk është shumë mirë, kështu mendova që ta ndihmoj pak mamanë. Megjithatë, nuk është ndonjë gjë shqetësuese.

- Oh, më vjen keq! Dhe je këtu duke festuar ardhjen e fëmijës sonë! - Tatsuhiko dukej i sikletosur.

Ajane tundi kokën.

- Jo, vërtet e them, mos u shqetësoni. Sikundër ju thashë, nuk ka asgjë shqetësuese, - pastaj, duke iu drejtuar Hiromit, tha: - Nëse ka ndonjë problem, ke numrin tim të celularit.

- Kur do të kthehesh?

- Eh... - Ajane rrudhi ballin. - Sapo ta di me siguri se kur, do të të lajmëroj. Gjithsesi, nuk do të qëndroj gjatë.

- Mirë, dakord.

Hiromi i hodhi një shikim Joshitakës, por ky po shikonte gjetkë.

Si përfundim të tre u ndanë duke ecur në një rrugicë, që të nxirrte në rrugën kryesore, ku Tatsuhiko ndaloi një taksì. Hiromi, e cila do të zbriste e para, hipi e fundit.

- Shpresoj të mos kemi folur shumë për fëmijët, - tha Jukiko ndërkohë që taksia po largohej.

- E, pastaj? Ishte një festë për lindjen e të voglit, apo jo? - tha Tatsuhiko nga ndenjësja e parë.

- Mendova se mund të ishim treguar pak më të kujdesshëm. Po mundohen të kenë një fëmijë, apo jo?

- Po, Joshitaka ma përmendi pak kohë më parë...

- Po nëse nuk do ia dalin të kenë? Hiromi, ti di gjë?

- Jo. Më vjen keq.

- Oh! - mërmëriti Jukiko, e zhgënjyer.

Hiromi pyeti veten nëse ishin ofruar ta shoqëronin vetëm për t'i marrë ndonjë informacion.

Mëngjesin tjetër, si zakonisht, Hiromi doli nga apartamenti në orën nëntë fiks për të shkuar te *Shtëpia e Anës*, në Daikanyama. Kishin përshtatur si klasë një apartament dhe aty mësonin teknikat e *patchwork*-ut. Kishte qenë një ide e

Ajanes, dhe tridhjetë nxënëse vinin për të mësuar teknikat e endjes direkt nga ajo.

Jashtë pallatit, Hiromi u befasua kur pa Ajanen në këmbë, me një valixhe.

- Ajane! Ka ndodhur gjë?

- Jo, doja vetëm të të jepja diçka para se të nisesha, - Ajane futi dorën në xhepin e xhaketës dhe nxori një çelës.

- Çfarë është?

- Çelësi i shtëpisë sonë. Si të thashë, nuk e di se kur do të kthehem... Dua ta mbash ti, për çdo rast.

- Kuptoj.

- E ke problem?

- Jo, absolutisht. Por është një kopje e dytë, apo jo? E keni një tjetër me vete?

- Oh, nuk më duhet! Do të telefonoj përpara se të kthehem dhe, nëse nuk mund të vish, do të ma hapë im shoq.

- Nëse dëshironi kështu...

- Të falënderoj! - Ajane vuri çelësin në dorën e Hiromit, duke ia shtrënguar fort gishtat.

- Mirupafshim! - tha Ajane dhe u largua duke tërhequr valixhen.

- Prisni, - e thirri Hiromi, mendueshëm. Pastaj, me zë më të lartë thirri: - Ajane?

Gruaja ndaloi duke u kthyer.

- Po?

- Jo, jo... asgjë. Udhë të mbarë!

- Faleminderit! - Ajane e përshëndeti me dorë dhe rifilloi të ecte.

Mësimet e *patchwork*-ut mbaronin natën vonë dhe Hiromi nuk kishte asnjëherë një moment për vete. Pasi përshëndeti nxënëset e fundit, vuri re që i kishte shpatullat dhe qafën

të ngrira, të ngurtësuar si dru. Sapo kishte përfunduar së pastruari klasën, kur i ra zilja e celularit. I hodhi një sy ekranit dhe u përtyp. Ishte Joshitaka.

- I mbarove leksionet për sot? - pyeti sapo ajo afroi celularin në vesh.

- Po, sapo mbarova.

- Mirë. Jam jashtë me klientë, por do të kthehem në shtëpi sapo të mundem. Kalo të takohemi.

Kishte një ton zëri kaq të shpenguar, saqë Hiromi nuk diti ç'të përgjigjej.

- Gjithmonë nëse nuk ke plane të tjera.

- Jo, ç'thua... je i sigurt që mund të vij?

- Sigurisht që mundesh. E more vesh, do të jetë larg për ca kohë.

Hiromi i hodhi një sy çantës. Në xhepin e brendshëm ishte celësi, që Ajane ia kishte dhënë në mëngjes.

- Dua të bisedojmë për diçka, - shtoi Joshitaka.

- Çfarë?

- Do të ta them pastaj. Do të jem në shtëpi në orën nëntë. Më telefono para se të vish, - tha ai duke e mbyllur përpara se ajo të përgjigjej.

Hiromi hëngri diçka vetëm në një *Noodle Bar*, pastaj telefonoi Joshitakan. Ishte në shtëpi dhe i tha me një zë të shqetësuar që të shkonte shpejt.

Ndërkohë që taksia po e çonte drejt shtëpisë së Mashibave, Hiromi ndjeu paksa neveri për veten. E bezdiste fakti që Joshitaka nuk kishte pikën e ndjenjës së fajit për atë që po ndodhte, por në të njëjtën kohë, duhet të pohonte që ndihej e lumtur.

Joshitaka e priti te dera duke buzëqeshur. Nuk u ngut që ta shoqëronte brenda. Lëvizjet e tij ishin të qeta dhe të sigurta. Në sallon Hiromi ndjeu aromën e kafesë.

- Ka muaj që nuk bëj kafë, - tha Joshitaka, duke dalë nga kuzhina me nga një filxhan në secilën dorë. - Shpresoj mos ta kem katranosur.

I dha një filxhan.

- Më duket se s'të kam parë të vësh këmbë në kuzhinë.

- Eh, në fakt! Që kur jam martuar s'kam lëvizur gishtin në shtëpi.

- Është një grua flori, - murmuriti Hiromi. Piu kafënë. Ishte e errët dhe pak e hidhur.

Joshitaka u ngërdhesh.

- Kam hedhur shumë kafë.

- Të të bëj një tjetër?

- Jo, lëre fare. Nuk të ftova këtu për të pirë kafe.

Mbështeti filxhanin te rafti prej mermeri.

- Dje bisedova me të.

- Ma mori mendja.

- Nuk i thashë se je ti. Mendon se është dikush që njeh.

Gjithmonë nëse u beson fjalëve të mia.

Hiromit iu kujtua mëngjesi, shprehja e fytyrës së Ajanes kur ia kishte dhënë çelësin. Nuk i ishte dukur se kishte ligësi në atë buzëqeshje.

- Çfarë tha?

- E pranoi.

- Vërtet?

- Po, vërtet. Ta kisha thënë.

Hiromi tundi kokën.

- Ndoshta nuk duhet të ta them unë, por nuk arrij ta kuptoj sesi mund ta *pranojë*.

- Sepse këto ishin rregullat. Rregullat që i kisha përcaktuar unë, por sido që të shkojë... s'ke pse frikësohesh. Gjithçka u rregullua.

- Atëherë jemi të sigurt?

- As mos e diskuto! - tha Joshitaka duke e afruar për kah vetja. Hiromi u dorëzua në atë përqaftim. Ndjeu buzët e tij afër veshit. - Duhet të flesh këtu sot.

- Në dhomën e gjumit?

Joshitaka buzëqeshi.

- Kemi edhe një dhomë për miqtë, me shtrat martesor.

Hiromi pohoi, e gjendur në një përzierje të çuditshme ndjenjash midis pështjellimit, lehtësimit dhe nervozizmit që s'i ndahej.

*

Mëngjesin tjetër, Hiromi ishte në kuzhinë duke përgatitur kafënë, kur Joshitaka hyri dhe i kërkoi t'i tregonte se si bëhej.

- Di vetëm atë që më ka mësuar Ajane.

- Mirë. Ma thuaj, - tha Joshitaka duke kryqëzuar duart.

Hiromi vendosi kafënë e bluar në filtër me një lugë me masë. Joshitaka u zgjat përpara për të parë sasinë.

- Më parë vendos pak ujë të ngrohtë. Vetëm pak. Pastaj prit që pluhuri të fryhet, - mori ibrikun dhe hodhi pak ujë të zierë në sitë, priti rreth njëzet sekonda, pastaj hodhi dhe pak. - Duhet të formosh një rreth. Kafeja ngrihet nga pak ndërkohë që hedh ujin, dhe duhet të kujdesesh që të qëndrojnë në të njëjtin nivel. Pastaj, ndërkohë që e hedh, shiko vizat në brokë dhe hiqe sitën sapo të kesh mjaftueshëm për dy veta. Nëse e lë më gjatë, do të bëhet e hollë.

- Shumë e ndërlikuar.

- Dikur e bëje edhe ti?
- Po, por me një ibrik. Ajane e hodhi kur u martuam. Thoshte se kur e bën në këtë mënyrë është më e mirë.
- Duke e ditur që je i droguar me kafë, me shumë mundësi donte vetëm të pije më të mirën.

Joshitaka buzëqeshi paksa dhe tundi kokën. Bënte gjithmonë kështu, kur Hiromi fliste për përkushtimin e madh që kishte Ajane për të, për shkollën ose për punën e tij.

Shijoi kafënë dhe iu desh të pranonte që ishte shumë e mirë. Ndërkohë që Joshitaka pinte kafënë, Hiromi përgatiti gjërat e saj. *Shtëpia e Anës* ishte e mbyllur të dielën, por Hiromi punonte si mësuese me kohë të pjesshme në një shkollë arti tradicional të Ikebukuros - një tjetër punë që e gjeti falë Ajanes.

Kur ishte gati për të dalë, Joshitaka i kërkoi ta telefononte pasi të mbaronte leksionet, për të darkuar së bashku. Hiromi nuk gjeti arsye të refuzonte.

Kishte kaluar ora shtatë kur Hiromi mbaroi leksionet. Ndërkohë që po përgatitej të dilte, mori telefonin dhe formoi numrin, por nuk pati asnjë përgjigje nga celulari i Joshitakës. E la të binte për pak, pastaj e mbylli dhe provoi ta merrte te numri i shtëpisë, por... e njëjta gjë.

Do të ketë dalë për një shëtitje? Nuk e linte asnjëherë celularin në shtëpi.

Hiromi vendosi të shkonte gjithsesi tek ai. Rrugës u përpoq ta telefononte disa herë, por pa pasur përgjigje.

Si përfundim u gjend përpara derës së shtëpisë së tij, ngriti kokën lart dhe pa dritën e sallonit ndezur. Por askush nuk përgjigjej në telefon, apo ziles së derës.

Duke shkundur shpatullat, Hiromi mori çelësin e Ajanes nga çanta, hapi derën dhe hyri. Drita e hyrjes ishte ndezur.

Hoqi shallin dhe kaloi korridorin e vogël. Ndjeu një aromë të mirë kafeje. Joshitaka duhet të kishte përgatitur kafë tjetër gjatë ditës.

Kur hapi derën e sallonit, shtangu.

Joshitaka ishte shtrirë në dysheme, nuk lëvizte, në një pozë të çrregullt. Pranë tij, kafeja e derdhur përdhe kishte marrë formën e një pellgu të vogël.

Duhet të telefonoj një ambulancë. Cili është numri, numri që të thonë të telefonosh... - me duart që i dridheshin, Hiromi nxori celularin nga çanta. Por nuk arrinte ta kujtonte aspak atë numër.

Tre

Disa shtëpi luksoze gjendeshin në anë të rrugës, e cila kishte një pjerrësi të lehtë. Edhe në dritën e zbehtë të fenerëve, ishte e qartë që bënin shpenzime të mëdha për mirëmbajtjen e tyre. Asnjë, në atë lagje, nuk dinte ç'do të thoshte të shtrëngoje rripin.

Përgjatë rrugës ishin parkuar makina të ndryshme policie. Kusanagi i dha taksistit një të goditur të lehtë mbi shpatull duke i thënë:

- Më ndalo këtu.

Zbriti nga taksia dhe pa orën, ndërkohë që u drejtua për kah vendi i krimit. Kishte kaluar ora dhjetë. *Më duket se nuk do të arrij ta shoh atë film.* E kishte humbur premierën në kinema, por e dinte që atë mbrëmje do të shfaqej në televizion. Kur iu përgjigj telefonatës kishte dalë me vrap, duke harruar të programonte regjistruesin.

Meqenëse ishte vonë, kureshtarët e zakonshëm nuk ishin përpara shtëpisë. Nuk kishin mbërritur as gazetarët. *Më jepni një çështje të thjeshtë dhe filmi mund të presë,* - mendoi ai pa qenë shumë i bindur.

Një polic, me një shprehje fytyre tipike për të tilla raste, ishte rojë përpara shtëpisë. Kusanagi i tregoi distinktivin dhe agjenti e përshëndeti.

Ndaloi një moment, para se të ngjitej deri te hyrja. Dukej sikur të gjitha dritat në shtëpi ishin të ndezura. Nga brenda dëgjoheshin murmuritje zërash.

Ndërsa vëzhgonte kopshtin, pa një njeri në këmbë pranë një gardhi. Ishte shumë errët për t'ia dalluar fytyrën.

Por nga trupi dhe nga gjatësia e flokëve, Kusanagi e kuptoi menjëherë se kush ishte.

Shkoi drejt saj.

- Ç'bën këtu?

Karou Utsumi u kthye me ngadalë, aspak e befasuar që po e shihte.

- Mirëmbërëma, detektiv.

- Ç'bën këtu jashtë? - pyeti.

- Asgjë. Po kontrolloja gardhin dhe lulet në kopsht. Ka të tjera në tarracë.

- Çfarë të tjerash?

Ajo tregoi lart.

- Lule.

Kusanagi ngriti shikimin dhe pa se në fakt ishte një tarracë në katin e parë, në atë anë të shtëpisë, me lule dhe gjethë që dilnin nga kangjellat. Nuk dukej se kishte ndonjë gjë veçanërisht interesante.

U kthye për të parë ndihmësdetektiven dhe më pas i tha:

- Përse nuk je brenda?

- Shumë turmë. Ka shumë njerëz.

- Nuk jemi shumë të shoqërueshëm, ë?

- Mendoj se nuk ka shumë kuptim të rrish aty, duke parë diçka që e kanë parë të gjithë. Nuk doja ta pengoja punën e policisë shkencore, kështu që preferova të hetoja nga larg.

- Por nuk po heton gjë. Po shikon lulet.

- Banesën e pashë rreth e përqark.

- Mirë. Të paktën i hodhe një sy skenës së krimit?
- As kam hyrë fare brenda. U ktheva mbrapsht te hyrja, - u përgjigj Utsumi.

Kusanagi e pa gjithë kureshtje. Përvoja i kishte mësuar se instinkti natyral i një detektivi të çonte të hetoje pikësëpari vendin e krimit. Por, me sa duket, rekrutja e re e departamentit, nuk e kishte një instinkt të tillë.

- E vlerësoj interesin tënd për pjesën e jashtme, por tani duhet të vish brenda me mua. Ka shumë gjëra që duhet t'i shohësh me sytë e tu, nëse do që puna të bëhet si duhet.

Kusanagi u kthye për kah dera. Utsumi e ndoqi në heshtje. Brenda shtëpia ishte plot me njerëz. Kusanagi pa agjentë të rajonit vendor të policisë dhe njerëz të departamentit të tij që silleshin sa andej këtej.

Ndihmësdetektiv Kishitani e vuri re dhe u iu afrua.

- Më falni që ju telefonova kaq herët, zotëri, - tha me një buzëqeshje ironike mbi buzë.

- Ka ndonjë problem me oraret që bëj? - murmuriti Kusanagi. - Kemi të bëjmë me vrasje, të paktën?

- Nuk e dimë ende me siguri. Por, është e mundur.

- Më shpjego gjithçka. Me fjalë të thjeshta.

- Atëherë, praktikisht një burrë, pronari i shtëpisë, ka vdekur. Në sallon. Vetëm.

- Jemi të sigurt që ishte vetëm?

- Ejani.

Kishitani e çoi Kusanagin në sallon, Utsumi i ndoqi. Ishte një dhomë e madhe - *gati pesëdhjetë metra kub*, - mendoi Kusanagi. Kishte dy divane jeshile prej lëkure dhe një tavolinë mermeri në qendër.

Në dysheme, pranë tavolinës, ishte shënjuar forma e kufomës me ngjithës të bardhë. Trupin tashmë e kishin larguar

prej aty. Kishitani pa profilin e vizatuar, para se të kthehej nga Kusanagi.

- I ndjeri quhej Joshitaka Mashiba, i martuar, pa fëmijë.

- Ma thanë para se të vija këtu, - tha Kusanagi. - Ishte drejtues i një shoqërie, apo jo?

- Po, një shoqërie informatike. Meqë sot është e diel, nuk ishte në punë. Nuk dimë as nëse ka dalë nga shtëpia.

- Banja ishte e lagur? - pyeti Kusanagi, pasi vuri re një njollë.

- Kafë. E gjetur pranë kufomës. Një prej njerëzve të grupit të policisë shkencore e mori atë me një shiringë. Aty gjendej dhe një filxhan kafeje i përmbysur.

- Kush e gjeti trupin?

- Hëm... - Kishitani hapi bllokun e tij. - Një grua me emrin Hiromi Uakajama. Një prej nxënëseve të së shoqes. Për të qenë më i saktë, ndihmësja e saj.

- Ndhimëse për çfarë?

- E shoqja është një *designer* e famshme jorganësh *patchwork*.

- Ekzistojnë *designer* të famshme jorganësh?

- Me sa duket po. Është hera e parë që e dëgjoj edhe unë. Gratë mund të jenë në dijeni më shumë, - Kishitani i hodhi një sy Utsumit. - Ke dëgjuar ndonjëherë për një Ajane Mita? - e pyeti duke ia treguar bllokun, ku kishte shkruar emrin.

- Jo, - iu përgjigj ajo. - E, përse një grua duhet të ketë dijeni më shumë mbi të?

- Kështu mendova, - tha Kishitani duke kruar kokën.

Kusanagi mbajti të qeshurën ndërkohë që shihte dy vartësit. Më në fund, i gjori Kishitani kishte një rekrute të re, të gjithën për vete, për ta keqtrajtuar, dhe, për më tepër, grua. *Nuk ia ka absolutisht idenë sesi të sillet.*

- Si u gjet trupi? - pyeti Kusanagi

- E po, dje e shoqja e viktimës u nis për të shkuar te prindërit në Saporu. Duke mos e ditur se kur do kthehej, para se të ikte, ia la çelësat e shtëpisë zonjushës Uakajama, për çdo rast. Zonjusha thotë se e ka telefonuar zotin Mashiba për të ditur se si po ia dilte vetëm, por nuk kishte pasur një përgjigje, as në celular dhe as në telefonin e shtëpisë. Kështu që u shqetësua dhe erdhi këtu. Thotë se e ka telefonuar për herë të parë pas orës shtatë dhe se ka mbërritur këtu rreth orës tetë.

- Është ora kur gjeti kufomën?

- Pikërisht. Telefoni ndihmën e shpejtë nga celulari i saj. Ambulanca erdhi menjëherë dhe konstatoi që burri kishte vdekur. Sollën një mjek që ta ekzaminonte. Ndërkohë, kuptuan se kishte diçka të çuditshme dhe telefonuan rajonin... dhe ja ku jemi.

- Hëm, - Kusanagi foli nëpër dhëmbë dhe i hodhi një sy Utsumit, i cili ishte larguar drejt bufesë. - Domethënë ku është kjo... gruaja që gjeti trupin?

- Zonjushë Uakajama po pushon në një prej makinave. Komandanti është me të.

- Çfarë? Plaku paska ardhur tashmë? Nuk e pashë kur hyra, - tha Kusanagi i ngrysur. - E vendosën shkakun e vdekjes?

- Duket helmim. Me siguri, bëhet fjalë për një vetëvrasje... por nuk do të ishim këtu nëse nuk do të dyshonin për një vrasje, apo jo?

- Mmm, - Kusanagi ndoqi me sy detektiven Utsumi që hyri në kuzhinë. - Pra, kur zonjusha Uakajama mbërriti, e gjeti derën e mbyllur me çelës?

- Me sa duket, po.

- Edhe dritaret dhe dyert rrëshqitëse prej xhami?

- Kur mbërritën agjentët e rajonit gjetën gjithçka mbyllur, përveç dritares së banjës në katin e parë.

- Dhe është mjaftueshëm e madhe sa të lejojë një njeri të kalojë?

- Në të vërtetë nuk e di, por jo, besoj se jo.

- Në rregull. Pse njerëzit e rajonit mendojnë se është vrasje dhe jo vetëvrasje? - Kusanagi u ul mbi divan dhe i vendosi këmbët njëra mbi tjetrën. - Përse mendojnë se dikush i ka hedhur helm në kafë? Dhe nëse është kështu, si ia doli vrasësi të dilte? Diçka nuk shkon.

- Tani... nëse marrim parasysh vetëm vendin e krimit, ju jap të drejtë. Vështirë të ketë ndodhur kështu.

- Diçka nuk më përputhet?

- Ndërkohë që kolegët e rajonit hetonin vendin e krimit, celulari i të ndjerit, zotit Mashiba, filloi të binte. Ishte një restorant në *Ebisu*. Me sa duket burri kishte rezervuar një tavolinë për dy veta për sot në orën tetë të mbrëmjes. Po telefononin sepse nuk ishte paraqitur asnjëri. Sipas restorantit, rezervimi ishte bërë para gjysmë ore, në gjashtë e gjysmë. Dhe, sikundër thashë, zonjusha e ka telefonuar zotin Mashiba pak pas orës shtatë, pa pasur përgjigje. Nuk ka shumë kuptim që një njeri të rezervojë një tavolinë në restorant në gjashtë e gjysmë dhe të vetëvritet në shtatë.

- Pikërisht, - tha Kusanagi duke kruar cepin e vetullës me një gisht. - Nuk ka kuptim as fakti që ti nuk ma the menjëherë këtë.

- Më falni. Po më bënit aq shumë pyetje, sa që nuk pata mundësi.

- Mirë, - tha Kusanagi, duke goditur lehtë gjunjët tek ngrihej. Utsumi kishte dalë nga kuzhina dhe ishte kthyer në pikën e parë, përpara bufesë. - Ej, - e thirri Kusanagi,

- Kishitani po na raporton lajme të rëndësishme. Pse vërdallosesh?

- Dëgjova gjithçka. Faleminderit, detektiv Kishitani!

- Ju lutem! - murmuriti Kishitani.

- Ka ndonjë gjë që duhet të di mbi atë bufe?

- Shikoni këtu, - tha Utsumi, duke treguar brenda saj. - Kjo pjesë nuk ju duket pak më bosh se pjesa tjetër?

Në pikën që po tregonte, mbi një raft, ndodhej një hapësirë bosh, e gjerë aq sa mund të vihej një pjatë.

- Ndoshta po.

- Hodha një sy në kuzhinë dhe gjeta pesë gota shampanje në pjatlarëse.

- Pra, me shumë mundësi ka qenë vendi i tyre.

- Po, më duket se po.

- Domethënë? Çfarë na duhen gotat e shampanjës?

Utsumi ngriti shikimin drejt detektivit, duke hapur lehtësisht buzët. Pastaj tundi kokën, sikur të kishte ndërruar mendim.

- Nuk ka rëndësi, - tha. - Thjesht mendova se kanë pasur njerëz për darkë kohët e fundit. Në të kundërt, përse do të përdornin gotat e shampanjës?

- Më duket një vëzhgim i mprehtë. Një çifti i kamur, pa fëmijë, me shumë mundësi organizon shpesh darka. Por nuk më duket një detaj i rëndësishëm për të përcaktuar nëse ky burrë është vetëvrarë, ose jo.

Kusanagi u kthye nga Kishitani para se të vazhdonte.

- Njerëzit janë të ndërlikuar, ndonjëherë bëjnë gjëra kontradiktore. Nuk më intereson nëse kanë pasur njerëz për darkë, apo që ka rezervuar një tavolinë për në mbrëmje: nëse duan të vdesin, vdesin dhe kaq.

Kishitani psherëtiu dhe pohoi me kujdes.

- Po gruaja? - pyeti Kusanagi
- Më falni, cila grua?
- Viktima... domethënë gruaja e të ndjerit. A e ka telefonuar njeri?

- Ah, sigurisht! Ende nuk kanë arritur të flasin me të. Ndodhet në Saporo, dhe për më tepër jashtë qytetit. Edhe nëse do të arrinin ta kontaktonin, me shumë mundësi nuk mund të vijë këtu para ditës së nesërme.

- Pikërisht. Jo, nëse duhet të kalojë nëpër gjithë Hokaidon, - tha i lehtësuar Kusanagi. Nëse gruaja po kthehej, dikush do të duhej ta priste dhe, duke e njohur Mamijën, komandantin e divizionit, ai dikushi do të ishte me shumë siguri Kusanagi. Tashmë ishte vonë dhe ndoshta do të prisnin ditën e nesërme për të pyetur fqinjët. Kusanagi tashmë shpresonte të kthehej në shtëpi, kur fytyra e Mamijës u shfaq te pragu.

- Ja ku qenke, Kusanagi. Më bëhet qejfi që vendose të vish.

- Kam mjaft kohë që jam këtu. Kishitani më informoi mbi ngjarjen.

Mamija pohoi, më pas u kthye të shihte jashtë.

- Ju lutem, ejani, - tha, duke shoqëruar në sallon një grua të hollë, te të njëzetepesë në moshë. Flokët e saj, të gjatë mbi shpatulla, kishin ngjyrë të zezë natyrale. *E çuditshme për një grua të moshës së saj në kohët e sotme*, - mendoi Kusanagi. Ngjyra vinte në pah bardhësinë e lëkurës së saj. Edhe pse, duke parë rrethanat, ndoshta do të ishte me vend të thuhej se vajza ishte zverdhur. Por, sidoqoftë, ishte shumë e bukur dhe dinte të lyhej.

Hiromi Uakajama, - mendoi.

- Po thoshit që e gjetët kufomën sapo hytë në dhomë, saktë? - po e pyeste Mamija. - Pra, gjendeshit pak a shumë në pikën që jeni aktualisht?

Gruaja pa përdhe, mori kohën e nevojshme për të hedhur një sy përkrah divanit dhe të rimendonte momentin e zbulimit.

- Po, - u përgjigj me gjysmë zëri. - Pikërisht këtu.

Kusanagit i dukej se vajza mezi qëndronte në këmbë, ndoshta se ishte e dobët, ose ndoshta se ishte e zverdhur. *Është ende e tronditur*, - mendoi. *Nuk është për t'u habitur.*

- Është hera e fundit që keni qenë në këtë dhomë duke marrë parasysht dy mbrëmjet e shkuara? - pyeti Mamija, duke kërkuar pohime.

Hiromi pohoi.

- Vini re ndonjë gjë ndryshe nga atëherë? Qoftë edhe një detaj të vogël.

Vajza hodhi një sy përreth, gati e frikësuar, pastaj tundi kokën.

- Nuk e di. Kishte edhe njerëz të tjerë dhe sapo kishim darkuar...

I dridhej zëri.

Mamija pohoi; vetullat pranë njëra-tjetrës dukej sikur shprehnin një ndjenjë mirëkuptimi: *mos u shqetësoni, është normale që nuk ju kujtohet.*

- Mirë, nuk do t'ju mbajmë më gjatë sot. Shkoni në shtëpi dhe qetësohuni. Kam frikë se do të na duhet të flasim sërish me ju nesër, nëse nuk keni gjë kundër.

- Dakord, - tha Hiromi, - por në të vërtetë kam frikë se nuk kam shumë për t'ju thënë.

- E di, por duhet të sigurohemi që e kemi të gjithë informacionin e mundshëm. Shpresoj do të na ndihmoni.

- Në rregull, - tha ajo, pa ngritur sytë.

- Do t'i them njërit prej njerëzve të mi t'ju shoqërojë në shtëpi, - tha Mamija duke parë Kusanagin. - Me çfarë erdhe sot? E ke marrë makinën?

- Me taksi, më vjen keq.

- Po sigurisht, sot do ta lije makinën në shtëpi.

- Nuk po e përdor shumë në këtë periudhë.

Mamija nuk arriti ta fshehte zhgënjimin e tij.

- Kemi timen, - ndërhyri Utsumi

Kusanagi u kthye.

- Ke makinë? Në Tokio? Me rrogën që ke?

- Isha në restorant kur më telefonuat. Më falni.

- Nuk është e nevojshme të kërkosh falje, - tha Mamija. - Mund ta shoqërosh në shtëpi zonjushë Uakajaman?

- Sigurisht. Por a mund t'i bëj një pyetje fillimisht?

- Çfarë pyetje? - tha Mamija, i befasuar nga kërkesa e papritur e rekrutes.

Hiromi u duk sikur ngriu.

- Dal në përfundimin se zoti Mashiba po pinte kafë kur ka rënë, dhe po pyesja veten, nuk përdorte asnjëherë një pjatëz bashkë me filxhanin?

Hiromi hapi paksa sytë dhe pa anash.

- Ndoshta jo, nëse e pinte vetëm.

- Kjo do të thotë se ka pasur një mik, dje ose sot, - tha Utsumi me siguri. - Keni ndonjë mendim se kush mund të ketë qenë?

Kusanagi e vështroi.

- Nga ta di se ka pasur një mik?

- Te lavapjata janë një filxhan dhe dy pjata të palara. Nëse zoti Mashiba ka pirë kafë vetëm, atëherë nuk duhet të ishte një pjatë, dhe aq më pak dy.

Kishitani shkoi në kuzhinë dhe u kthye menjëherë.

- Ka të drejtë. Një filxhan dhe dy pjata.

Kusanagi shkëmbeu një vështrim me Mamijën para se të shikonte sërish vajzën, Hiromi Uakajama.

- A ju kujtohet ndonjë gjë? - e pyeti.

Vajza tundi kokën.

- Unë... nuk e di, - zëri i saj shprehte ankth. - Domethënë, nuk kam qenë këtu pas darkës së mbrëmjes së shkuar. Si mund ta di nëse ka pasur miq?

Kusanagi i hodhi sërish një vështrim shefit të tij, i cili pohoi. Kishte një shprehje të shqetësuar në fytyrë.

- Mirë, ju mbajtëm mjaftueshëm. Shoqërojeni në shtëpi Utsumi. Kusanagi, ti mund të shkosh me ta.

- Po, zotëri, - tha Kusanagi duke nënkuptuar qëllimet e Mamijës. Ishte e qartë që zonjusha Uakajama fshihte diçka, dhe i takonte atij ta detyronte të fliste.

Dolën të tre bashkë dhe Utsumi u kërkoi atyre të prisnin, ndërkohë që shkonte të merrte makinën, të cilën e kishte lënë në një parkim aty afër.

Teksa po prisnin, Kusanagi studioi vajzën që kishte pranë. Dukej e ligështuar, por ndoshta jo vetëm prej tronditjes që kishte gjetur një kufomë.

- Keni ftohtë? - e pyeti.

- Jo, jam mirë, faleminderit.

- Do shkonit gjëkund sot në mbrëmje?

- Sot? Po talleni?

- Po ju pyesja vetëm nëse kishit angazhime të tjera.

Hiromi lëvizi lehtësisht buzët. Dukej në mëdyshje, e pasigurt.

- Më falni, do t'ju kenë pyetur me qindra herë deri tani, por...

- Po?

- Çfarë ju shtyu, pikërisht sot, t'i telefononit zotin Mashiba?

- Atëherë, meqë zonja Mashiba m'i la çelësat, mendova se donte që unë ta kontrolloja ndonjëherë. Mendoj se kishte merak ta linte të shoqin vetëm, kështu nëse mund të isha e dobishme... - zëri i saj u venit.

- Dhe, duke parë që ai nuk përgjigjej, shkuaat në shtëpi?

- Po, - tha duke lëvizur lehtë kokën.

Kusanagi harkoi njerën vetull.

- Por, ama, ndodh që njerëzit nuk përgjigjen në telefon. Ndoshta kishte dalë dhe nuk mund të përgjigjej për një arsye çfarëdo. Nuk e menduat?

Pas një momenti heshtjeje, Hiromi tundi kokën duke thënë:

- Më duket se jo.

- Përse jo? Ishit e shqetësuar për ndonjë gjë në veçanti?

- Jo, absolutisht. Ndoshta ishte vetëm një parandjenjë...

- Një parandjenjë?

- Ka ndonjë gjë të keqe që dikush ndien diçka të çuditshme?

- Asgjë, sigurisht. Në të vërtetë, më bën përshtypje. Jo të gjithë ata të cilëve iu besohen çelësat e shtëpisë janë kaq të përgjegjshëm. Dhe, me sa duket, parandjenja juaj ishte e saktë, ndaj mendoj se keni bërë një gjë të shkëlqyer.

Hiromi vështroi gjetkë. I dukej e tepërt t'i merrte për bazë fjalët e Kusanagit.

Një makinë e kuqe e errët, e llojit *Mitsubishi Pajero*, ndaloi përpara shtëpisë. Karou Utsumi hapi derën dhe zbriti.

- E llojit "4x4"? - tha Kusanagi, i ngelur me gojë hapur.

- Ta ngasësh është më e lehtë nga ç'mendon, - tha Utsumi.

- Zonjusha Uakajama? - tha teksa hapi derën e pasme dhe Hiromi hipi, e ndjekur nga Kusanagi.

Utsumi u ul në timon dhe vendosi navigatorin, - si duket, e dinte adresën e zonjushës Uakajama. Bëhej fjalë për një

apartament afër stacionit të trenit të *Gakugei-dai-gaku*. Sapo makina u nis, Hiromi u përkul përpara.

- Ishte aksident, apo... vetëvrasje, ajo që i ndodhi zotit Mashiba?

Kusanagi hodhi një vështrim për kah vendi i shoferit. Vështrimi i tij u përplas me atë të Utsumit te pasqyra e pasme.

- E pamundur të thuhet, pa bërë autopsinë, - u përgjigj.

- Jeni të skuadrës së vrasjeve, apo jo?

- Po, por erdhëm me idenë se *mund* të jetë një vrasje. Nuk mund të thuhet gjë tjetër, sepse nuk dimë më shumë as ne.

- Kuptoj, - tha Hiromi me gjysmë zëri.

- Meqë ra fjala, - vuri në pah Kusanagi me një ton shumë të shpenguar, - doja t'ju pyesja, zonjusha Uakajama: nëse do të ishte një vrasje, keni ndonjë ide se kush mund ta ketë bërë?

Iu duk se nuk po merrte frymë. Ia pa gojën.

- Jo, - tha Hiromi, me zë të mekur dhe të ulët. - Në të vërtetë nuk di asgjë më shumë për zotin Mashiba, përveç faktit që është burri i mësues sime të *patchwork*-ut.

- Sigurisht. Por nëse ju vjen ndër mend diçka, e dimë se mund të kemi ndihmën tuaj.

Hiromi qëndroi e ulur në heshtje, pa pohuar.

E zbritën përpara pallatit të saj. Kusanagi u ul përpara.

- Atëherë, - tha duke parë përpara, - si mendon?

- Është tip i vendosur, - iu përgjigj Utsumi duke u futur sërish në trafik.

- A thua?

- Nuk qau një herë të vetme. Të paktën jo përpara nesh.

- Ndoshta nuk ishte kaq e trishtuar.

- Jo, kishte qarë përpara se të mbërrinim. Do të thosha gjatë gjithë kohës që ka pritur në ambulancë.

- Nga e di këtë gjë?

- Grimi. Ishte e dukshme që e kishte sistemuar me shpejtësi.

Kusanagi vështroi detektiven e re.

- Vërtet?

- Nuk kam asnjë dyshim.

- Më duket se gratë vënë re gjëra të tjera, dhe ki parasysh që ky është një kompliment.

- E di, - tha ajo duke buzëqeshur. - Po juve, detektiv Kusanagi, si ju duk?

- Me një fjalë? E dyshimtë. Kam dyshime te një vajzë që thotë se shkoi në shtëpinë e një burri për *të parë si ishte*, qoftë me, apo pa çelës.

- Jam dakord. Unë, me siguri, nuk do ta kisha bërë.

- Mendon se mes saj dhe të ndjerit ka pasur ndonjë gjë? Apo po ngutem shumë?

Utsumi gati shfry.

- Nuk do të thosha që po nguteni shumë. Vështirë të mos mendosh që *nuk kanë pasur* gjë. Sipas meje kanë pasur në plan të darkonin bashkë sot.

Kusanagi i ra gjurit me grusht.

- Restoranti i *Ebisus*-it!

- Kanë telefonuar ngaqë nuk u paraqit askush, dhe rezervimi ishte për dy persona. Që do të thotë se edhe personi, me të cilin do të darkonte zoti Mashiba, nuk është paraqitur.

- Dhe ky person mund të jetë pikërisht Hiromi Uakajama, - pohoi Kusanagi.

- Nëse ka pasur gjë mes tyre, do ta zbulojmë shumë shpejt.

- Por, si?

- Filxhanët në lavapjatë. Mund t'i kenë përdorur për të pirë një kafé bashkë, dhe në atë rast te njëri prej tyre do të gjendeshin gjurmët e vajzës.

Kusanagi ngriti një gisht.

- Dakord, dakord. Por një marrëdhënie e mundshme nuk mjafton që ta kthejë në një të dyshuar.

- Sigurisht që jo, - tha Utsumi. Hapi krahun dhe fiku makinën. - Ju vjen keq të bëj një telefonatë? Dua të kontrolloj diçka.

- Kë po telefonon?

- Patjetër që Hiromi Uakajaman.

Utsumi formoi numrin e saj në celular, ndërkohë që detektiv Kusanagi e shihte me gojë hapur. Personi nga ana tjetër u përgjigj gati menjëherë.

- Zonjushë Uakajama? Jam Utsumi, nga departamenti i policisë. Më falni që ju bezdis sërish dhe kaq shpejt. Harrova t'ju pyes ç'programe keni për nesër? - pati një heshtje ndërkohë që Hiromi po fliste nga ana tjetër, pastaj Utsumi vazhdoi: - Kuptoj. Faleminderit! Më falni që ju shqetësova. Natën e mirë! - dhe mbylli komunikimin.

- Çfarë tha? - pyeti Kusanagi.

- Që nuk ka programe dhe që besonte se do të qëndronte në shtëpi. Do të bënte një ditë pushim në shkollën e *patchwork*-ut.

- Mmm, - murmuriti Kusanagi.

Utsumi vështroi detektivin me bisht të syrit.

- Nuk i telefonova për të ditur programet e saj.

- Hë, pra, fol të shkretën.

- Edhe pse mendohej ta fshihte, kuptohej nga zëri që po qante. Ishte e dukshme. Me fjalë të tjera, sapo ka mbetur vetëm në dhomën e saj, emocionet që mbajti brenda dolën jashtë.

Kusanagi u mbështet te sedilja.

- Për këtë e telefonove? Për të parë nëse po qante?

- Mendova se tronditja për gjetjen e një të vdekuri, qoftë ky i njohur, apo jo, ishte e mjaftueshme për ta bërë një njeri të qajë. Por të qash tani, shumë orë më pas...

- Do të thotë që ndien diçka përtej tronditjes për një ngjarje kaq të tmerrshme, - përfundoi Kusanagi. I buzëqeshi.
- Jo keq, ndihmësdetektive Utsumi!

- Faleminderit, detektiv Kusanagi! - uli frenat e dorës dhe u nis.

Mëngjesin e nesërm, pak pas orës shtatë, Kusanagi u zgjua nga telefoni. Ishte komandanti Mamija.

- Është herët, - murmuriti detektivi nga ana tjetër e telefonit.

- Falëndero Zotin që ke fjetur në shtëpinë tënde. Sot në mëngjes kemi një mbledhje mbi hetimet te rajoni qendror në Meguro. Ndoshta do të transferohemi aty, ndaj përgatitu ta kalosh natën aty.

- Po më telefononi në orën shtatë të mëngjesit për të më kujtuar të marr me vete furçën e dhëmbëve?

- Do të të pëlqente, ëëë? Jo, në mëngjes duhet të shkosh në Haneda.

- Haneda? Pse në Haneda?

- Në aeroport, apo jo? Zonja Mashiba po kthehet nga Sapore dhe dua që ti të shkosh ta marrësh dhe ta sjellësh te rajoni qendror.

- Di gjithçka, besoj?

- Me shumë mundësi. Dua të shkosh me Utsumin. Do ta drejtojë ajo makinën. Avioni mbërrin në tetë.

- Në tetë të mëngjesit? - Kusanagi uli receptorin dhe kërceu nga shtrati.

Ndërkohë që shpejtonte të përgatitej, ra celulari. Ishte Karou Utsumi, po e priste poshtë shtëpisë. Kusanagi mori kuletën, veshi këpucët dhe nxitoi të dilte.

Utsumi ishte buzë rrugës. Kusanagi hipi te *Pajero*-ja dhe u nisën në drejtim të aeroportit të Hanedas.

- Më duket se na eci keq edhe këtë herë. Nuk do të mësohem kurrë t'ia dal mbanë me familjarët në zi, - tha Kusanagi duke vendosur rripin.

- Por shefi thotë që ju jeni më i miri për këto gjëra.

- Plaku tha kështu?

- Tha se keni një fytyrë qetësuese.

- Bukur, - shfryu Kusanagi, - me pak fjalë, dukem si idiot.

Mbërritën në aeroport në tetë pa pesë dhe qëndruan në dhomën e pritjes duke vështruar pasagjerët që mbërrinin, në mënyrë që të dallonin Ajane Mashibën.

- Mund të jetë ajo? - tha Utsumi duke bërë një shenjë me kokë nga gruaja që po shkonte drejt tyre.

Kusanagi ndoqi shikimin e saj dhe pa një grua që përkonte me përshkrimin. I lexohej dhimbja në sy, të cilët i kishte ulur paksa poshtë, dhe e gjithë sjellja e saj kishte diçka të rreptë dhe të ngurtë... ndoshta solemne.

- Sigurisht që është ajo, - tha Kusanagi me zërin që iu ngjir papritur.

Ndihej sikur zemra iu ngjir papritur në grykë. E fiksoi, pa arritur t'i shkëpuste sytë prej saj, duke mos e kuptuar se pse e trazonte kaq shumë fakti që shihte Ajane Mashibën.

Katër

Në momentin që detektivet u prezantuan, Ajane Mashiba kërkoi menjëherë trupin e të shoqit.

- Gjykata ka urdhëruar të bëhet një autopsi, - shpjegoi Kusanagi. - Në këtë moment nuk e di se ku mund të ndodhet trupi saktësisht, por më vonë do të informohem e do t'ju bëj me dije.

- Domethënë nuk do mundem ta shoh.

Sytë e Ajanes ishin futur në zgavra, ndërsa lëkura i ishte skuqur; po sforcohej të përmbante lotët.

Dyshoj të ketë vënë gjumë në sy që kur ka marrë telefonatën.

- Kur të kenë mbaruar, do t'jua rikthejmë trupin e pajetë sa më shpejt të jetë e mundur.

Fjalët e Kusanagit tingëllonin të rënda, madje dhe për veshët e tij. Nuk ndihej kurrë i qetë kur kishte për të folur me familjarët, po për ndonjë arsye kësaj here ndihej dhe më i turpëruar. Gjithçka dukej më e vështirë se zakonisht.

- Faleminderit! - iu përgjigj Ajane.

Kishte zë të thellë për të qenë femër. Kusanagit i erdhën në mendje fjalë si “sensuale”, apo “joshëse”.

- Do të donim të flisnim me ju në komisariatin e policisë në Meguro, nëse nuk ju vjen keq.

- Po. Ma thanë në telefon.

- Mirë. Nëse jeni gati po ju shoqërojmë te makina.

Kusanagi e rehatoi në sediljen e pasme të *SUV*-it të Utsumit, pastaj u ul në vendin e pasagjerit.

- Kanë hasur probleme për t'ju lokalizuar mbrëmë. Ku ju gjetën? - tha ndërsa kthehej nga ajo.

- Isha në një llixhë pranë qytetit ku kam lindur. Shkova me një mikeshë të vjetër. Kam frikë se mund të kem fikur telefonin, prandaj nuk ju jam përgjigjur menjëherë. Mesazhet i dëgjova vetëm përpara se të shtrihesha për të fjetur, - bëri një pauzë, të cilën e ndoqi një frymëmarrje e gjatë. - Në fillim mendova mos ishte shaka. Nuk është e zakonshme që dikush të telefonohet nga policia.

- Janë gjëra që ndodhin pa paralajmërim, - ndërhyri Kusanagi.

- Pikërisht kështu, - tha ajo, - po çfarë lloj gjërash? Askush nuk më ka thënë asgjë, përveç se ai... - zëri iu vak, ndërsa Kusanagi ndjeu një shtrëngim në stomak. E dinte që përgjigjja për pyetjen që Ajane do të bënte ishte ajo të cilës i trembej më tepër.

- Çfarë ju kanë thënë në telefon? - e pyeti.

- Më thanë që im shoq kishte vdekur, që shkak i vdekjes së tij nuk ishte i qartë e për pasojë do të ndërmerreshin disa hetime. Kjo ishte e gjitha.

Qartësisht kjo ishte e gjitha ajo që kishte mundur t'i thoshte agjenti i ngarkuar me telefonatën. Kusanagi ndjeu një shtrëngim në gjoks, kur imagjinoi se si duhet ta kishte kaluar mbrëmjen Ajane, pasi kishte marrë lajmin, e sa e vështirë duhet të kishte qenë për të të merrte avionin atë mëngjes.

- Bashkëshorti juaj vdiq në shtëpi, - i tha. - Nuk e dimë akoma shkakun, por nuk ka shenja të jashtme në trup. Të vdekur e gjeti Hiromi Uakajama.

- Hiromi... - Kusanagi më shumë sesa ta dëgjonte, e ndjeu vajën e Ajanes. Kusanagi ktheu vështrimin drejt Utsumit, e cila ishte në timon. Për një çast vajza u kthye dhe vështrimet e tyre u takuan.

Po mendojmë të dy të njëjtën gjë, - mendoi Kusanagi. Kishin kaluar më pak se dymbëdhjetë orë, që kur kishin folur mbi mundësinë se Hiromi Uakajama dhe Joshitaka Mashiba kishin të bënë me njëri-tjetrin. Zonjusha Uakajama ishte e njohur për të gjithë si nxënësja e preferuar e Ajanes. Nëse e kishin zakon ta ftonin për darkë në shtëpinë e tyre, do të thotë që ishte mike e familjes. Nëse kishte fjetur me bashkëshortin e Ajanes, atëherë ishte rasti tipik i thikës pas shpine. Pyetja e vërtetë ishte nëse Ajane ishte në dijeni të ngjarjeve. Nuk mund të merrej si e mirëqenë që dinte gjithçka, vetëm sepse ishte tepër e afërt me asistenten e saj. Në të vërtetë Kusanagi kishte rastisur më shumë se një herë raste kur ishte vërtetuar e kundërta, domethënë persona që nuk e dinin arsyen përse ishin aq të afërta.

- Bashkëshorti juaj vuante nga ndonjë sëmundje?

Ajane shkundi kokën.

- Me sa di unë, jo. Bënte kontrollë të rregullta e nuk kishte probleme. As për të pirë nuk pinte shumë.

- Nuk kishte shfaqur kurrë më parë shenja deri tani?

- Jo. Absolutisht. As nuk mund ta imagjinoj diçka të tillë.

Ajane çoi dorën te balli, sikur po kërkonte të pengonte një dhimbje koke. Kusanagi vendosi se do të ishte e parakohshme të flitej për helmim. Në fakt, deri në momentin që nuk kishin rezultatet e autopsisë, ishte më mirë të mos flitej as për vetëvrasje e as për vrasje.

- Si pasojë e rrethanave jo të zakonshme, - tha, - duhet të verbalizojmë çdo detaj mbi vendin ku është gjetur trupi,

nëse kemi të bëjmë ose jo me një krim. Tashmë kemi kryer një pjesë të punës që mbrëmë me zonjushën Uakajama. Do të kishim preferuar që të ishit e pranishme dhe ju, sigurisht.

- Po, më bënë me dije dhe për këtë nëpërmjet telefonit.

- Shkoni shpesh në Saporò?

Ajane lëvizi kokën.

- Ishte hera e parë qëkur jam martuar.

- Prindërit tuaj, besoj, jetojnë atje? Gjithçka në rregull me ta?

- Im atë nuk gëzon shëndet të mirë, kështu që m'u duk e volitshme të shkoj ta vizitoj. Sigurisht, kur mbërrita e gjeta shumë më mirë seç mendoja, për këtë shkova në llixha.

Kusanagi miratoi.

- E, përse ia latë çelësin tuaj zonjushës Uakajama?

- Mendova që ishte më mirë kështu, në rast se do të nevojitej diçka ndërsa unë isha larg. Hiromi më gjendet gjithmonë në punën time, e në shtëpi mbaj shumë stofra e copa të përfunduara, që mund të shërbejnë gjatë leksioneve.

- Zonjusha Uakajama na tha që ishte e shqetësuar për bashkëshortin tuaj dhe që duke parë se nuk përgjigjej në telefon, ka kaluar nga shtëpia juaj për të parë nëse gjithçka ishte në rregull. Pyes veten... - detektivi i zgjodhi fjalët e kujdes, - a ju kujtohet nëse ju i keni kërkuar shprehimisht të kalonte për ta parë si ishte?

Ajane mbeti paksa e habitur.

- Nuk besoj, por mund të jetë ngaqë i kam lënë këtë përshtypje. Është gjithmonë aq e kujdesshme, dhe është hera e parë qëkur jemi martuar që e lija vetëm tim shoq... Ndoshta unë... - bëri një pushim të shkurtër përpara se të riniste. - Kam gabuar që ia kam lënë çelësin?

- Jo, absolutisht. Doja vetëm të konfirmoja atë që më tha dje zonjusha Uakajama.

Ajane fshehu fytyrën mes duarsh.

- Nuk mund ta besoj. Ai ishte mirë, gëzonte shëndet të plotë. Patëm ftuar miq për darkë, të premtën në mbrëmje. Ishte aq... aq i lumtur, - iu drodh zëri.

- E di që është e vështirë, - tha Kusanagi në mënyrën më delikate të mundshme, - dhe më vjen keq që më duhet t'jua kërkoj këto gjëra, por, për sa i përket darkës së të premtës... cilët ishin këta miq?

- Një ish-shok i shkollës së tim shoqi dhe bashkëshortja e tij, - tha emrat e Tatsuhiko dhe Jukiko Ikait. Pastaj la duart t'i binin në prehër ndërsa shikimi iu bë rëndë. - Duhet t'ju kërkoj diçka.

- Sigurisht, - tha Kusanagi, - më thoni.

- Duhet të shkojmë menjëherë në komisariatën e policisë?

- Keni nevojë të bëni diçka?

- Fillimisht do të dëshiroja të shikoja shtëpinë nëse është e mundur. Dua të di se ku ishte kur... Dua të di se si vdiq. A është e mundur?

Kusanagi i hodhi përsëri një shikim Utsumit. Kësaj here shikimet e tyre nuk u takuan. Detektivja e re dukej e përqendruar te rruga.

- Duhet të pyes përgjegjësën për rastin, - tha Kusanagi ndërsa merrte telefonin nga xhepi. Mamija u përgjigj ndërsa Kusanagi ia komunikoi kërkesën. Dëgjoi komandantin që, ndërsa lëshoi një psherëtimë të shkurtër, i tha:

- Dakord... Në të vërtetë gjërat kanë ndryshuar paksa. Ndoshta do të ishte më mirë nëse flasim në vendngjarje. Takohemi te shtëpia.

- Në çfarë kuptimi kanë ndryshuar?

Heshtje.

- Ta shpjegoj më vonë.

- Mirë.

Kusanagi mbylli komunikimin dhe u drejtua për nga Ajane.

- Po ju dërgojmë në shtëpi.

- Faleminderit, - iu përgjigj ajo me gjysmë zëri. Kusanagi u kthye të shikonte rrugën. Një çast më vonë dëgjoji se Ajane po mundohej të telefononte dikë.

- Alo, Hiromi? Jam unë.

Kusanagi u irritua. Nuk pritej të telefononte dikë aq më pak zonjushën Uakajama. Nuk mund t'i thoshte që duhej ta ndërpriste bisedën.

- ... e di, e di, - thoshte Ajane. - Tani jam me policinë. Po ikim drejt shtëpisë. Eh, nuk e di sesi do jesh ndier Hiromi!

Mendja e Kusanagit ishte si në lëmsh. Nuk arrinte të imagjinonte dot sesi mund të ishte reagimi i zonjushës Uakajama. Ndoshta ishte e dërrmuar nga dhimbja e humbjes së dashnorit të saj, e ndoshta mund të ishte dhe duke hapur thesin. Po të ishte ky rasti mund ta kishte të lehtë ta imagjinonte reagimin e Ajanes.

- ... kjo është ajo që më kanë thënë. Je mirë? Të lutem më thuaj që po ushqehesh... Mirë. Dëgjo, nëse nuk ka problem, a mendon se mund t'ia dalësh të vish. Do kisha shumë dëshirë të flisja me ty.

Kusanagi nuk priste që Ajane ta ftonte zonjushën Uakajama në shtëpi. Duke gjykuar nga ato copëza bisede, dukej se vajza ishte në gjendje të mbante akoma gjakftohtësinë.

- Je e sigurt se mund t'ia dalësh? Mirë, atëherë shihemi pastaj... Po, faleminderit. Kujdesu për veten.

Telefonata kishte mbaruar. Kusanagi dëgjonte gruan, e cila tërhiqte hundët në sediljen e pasme.

- Do të vijë dhe zonjusha Uakajama?

- Po. Oh! Shpresoj që të mos jetë problem.

- Asnjë problem. Ishte pikërisht ajo që e gjeti, ndoshta do të ishte më mirë sikur t'jua tregonte ajo ngjarjen, - tha detektivi, ngazëllimi i të cilit po rritej. Nga njëra anë ishte diçka interesante të shihje se si dashnorja e viktimës do t'i shpjegonte bashkëshortes zbulimin e kufomës. Nga ana tjetër shpresonte që, ndërsa kundronte Ajanen me kujdes, do t'ia dilte të kuptonte se ajo ishte në dijëni të tradhtisë së të shoqit.

Lanë superstradën dhe gjarpëruan drejt rrugës lokale, e cila të çonte në shtëpinë e Mashibave. Dukej se Utsumi orientohej mjaft mirë: ndoshta e kishte memorizuar trajektoren.

Kur mbërritën te shtëpia, gjetën komandantin Mamija që po i priste. Qëndronte në këmbë përpara portës bashkë me Kishitanin.

Zbritën nga makina dhe u afruan, ndërsa Kusanagi prezantoi Ajanen me dy detektivët e tjerë.

- Më vjen keq për bashkëshortin tuaj! - u shpreh Mamija; pastaj pyeti Kusanagin: - Ia ke treguar të gjitha?

- Në vija të trasha.

Mamija i hodhi vejushës një vështrim mëshirues.

- Si mund ta imagjinoni, do të kishim nevojë t'ju pyesnim për shumë informacione. Më vjen keq t'ju shqetësoj pikërisht tani që sapo jeni kthyer.

- Mos u shqetësoni.

- Do të ishte më mirë që të hynim brenda. Kishitani, çelësin.

Kishitani ia zgjati çelësin Ajanës, e cila e mori me një çehre të ngrirë e të turbulluar.

Hapi derën dhe u fut në shtëpi. Të tjerët e ndoqën me Kusanagin të fundit, që mbante valixhen e të vesë. Me të hyrë brenda Ajane pyeti:

- Ku ishte?

- Nga kjo anë, - iu përgjigj Mamija ndërsa vazhdonte të ecte drejt korridorit. Në dyshemenë e sallonit ishte akoma letra ngjitëse e fiksuar në tokë. Ajane pa formën dhe u ndal duke mbyllur gojën me një dorë.

- Zonjusha Uakajama thotë se e ka gjetur të shtrirë këtu, në dysheme, kur hyri brenda, - shpjegoi Mamija.

Ajane u rrëqeth; këmbët e tradhtuan e ra mbi gjunjë. Kusanagi pa që i dridheshin shpatullat dhe dëgjoi një zhurmë të ngjashme me lemnë. Ajane mbajti frymën dhe pyeti me gjysmë zëri:

- Në çfarë ore ndodhi?

- E gjeti rreth orës tetë, - iu përgjigj Mamija.

- Tetë... Çfarë ishte duke bërë?

- Me sa duket ishte duke pirë një kafë. Kishte një filxhan mbi dysheme dhe një pjesë e lëngut ishte derdhur.

- Kafë... - Ajane ngriti shikimin. - E kishte përgatitur ai?

- Më fal? - tha Kusanagi.

Ajane tundi kokën.

- Jo, nuk e kishte zakon. Nuk e kam parë kurrë të përgatisë një kafë.

Kusanagi vërejti një puls në vetullat e Mamijës.

- Nuk përgatiste kurrë kafë? - pyeti komandanti.

- E po, di që e bënte përpara se të martoheshim. Por kishte një ibrik kafeje.

- Tani nuk e keni më?

- Jo. Nuk më hynte më në punë, kështu që e hodha. Përdor një kullësë për një filxhan të vetëm.

Shikimi i Mamijës u ngurtësua.

- Zonjë, - tha, - nuk mund të marr asgjë për të mirëqenë, përpara rezultateve të autopsisë, por mundësitë janë që bashkëshorti juaj të jetë helmuar.

Shprehia e Ajanes për një moment u duk e përhumbur e më pas gruaja zgurdulloi sytë.

- Helmuar? Doni të thoni helmim nga ushqimi?

- Jo. Në kafënë pranë kufomës kemi gjetur një helm mjaft të fuqishëm, edhe pse nuk e dimë akoma se për çfarë bëhet fjalë. Kjo do të thotë se vdekja e bashkëshortit tuaj nuk ka qenë e provokuar nga një sëmundje ose fatkeqësi.

Ajane mbuloi përsëri gojën dhe puliti më shumë qepallat. Sytë e saj sa vinin e skuqeshin përherë e më tepër.

- Si... si mund të ketë ndodhur?

- Nuk e dimë. Për këtë doja t'ju pyesja nëse mund të kishit ndonjë ide.

Qartësisht ishte kjo arsyeja pse Mamija kishte nënkuptuar kur kishte thënë se gjërat kishin ndryshuar, mendoi Kusanagi. Tashmë e kishte të qartë pse komandanti kishte ardhur vetë në vendngjarje. Ajane shtypi gishtat në ballë dhe u ul në divanin më të afërt.

- Jo. Nuk kam as më të voglën ide.

- Kur ka qenë hera e fundit që keni komunikuar me bashkëshortin tuaj? - pyeti Mamija.

- Të shtunën në mëngjes. Dolëm bashkë nga shtëpia kur isha duke ikur për në aeroport.

- Keni vërejtur diçka të çuditshme tek ai, ose në sjelljen e tij? Dhe detaji më i vogël mund të na shërbejë shumë.

Ajane qëndroi e ulur pa lëvizur për një moment, sikur të ishte duke reflektuar thellësisht; pastaj tundi kokën me vendosmëri.

- Jo, nuk më vjen asgjë ndër mend.

Po, sigurisht, - mendoj Kusanagi. - Të durosh goditjen e vdekjes së bashkëshortit, duke ditur vetëm që kishte ndodhur në rrethana misterioze, pastaj të marrësh vesh që ka vdekur nga helmimi...

- Ndoshta duhet t'ju lëmë të pushoni pak, - ndërhyri Kusanagi. - Ka mundësi të jeni lodhur nga udhëtimi në Sapro.

- Po, ndoshta keni të drejtë, - tha komandanti.

- Jo, jam mirë, - tha Ajane duke i dhënë shpirt vetes. - Vetëm se do t'jua dija për nder sikur të kisha mundësinë të ndërrohesha. Kam akoma në trup veshjet e mbrëmjes së shkuar.

Në trup kishte të veshur një kostum të errët.

- Që mbrëmjen e djeshme? - pyeti Kusanagi.

- Po. Shpresoja që t'ia dilja të kthehesha në Tokio më herët, dhe të isha e veshur për udhëtimin.

- Atëherë, ju nuk paskeni fjetur?

- Edhe po të doja nuk do të mundja.

- E po kështu nuk shkon, - tha Mamija. - Besoj se ju duhet pushim përpara se të vazhdoni më tutje.

- Jo, jam mirë. Më mjafton vetëm koha për t'u ndërruar dhe jam gati, - konfirmoi Ajane.

Kusanagi e pa të dilte nga dhoma, pastaj u kthye për nga Mamija.

- Çfarë dimë për helmin?

Mamija pohoi.

- Kishte gjurmë acidi arsenik në kafë.

Kusanagi hapi sytë.

- Arsenik? Si në rastin e *curry*-t të helmuar në atë mensën shkollorë?

- Departamenti shkencor mendon që përbërja e përdorur në këtë rast të jetë arsenik sodiumi. Nga përqendrimi i marrë nga kafja, duket që zoti Mashiba të ketë marrë një dozë më të madhe sesa nvojitet për të qenë vdekjeprurëse. Duhet të kemi rezultate më të detajuara rreth mesditës, por helmimi nga acidi arsenik korrespondon me kushtet në të cilat është gjetur kufoma.

Kusanagi miratoi me kokë ndërsa merrte frymë. Mundësitë që kjo vdekje të ishte rastësore po afroheshin tashmë drejt zeros.

- Por, nëse është e vërtetë që zoti Mishiba nuk përgatiste kurrë kafënë, kush ia ka përgatitur? - tha Mamija me vete, por më zë mjaftueshëm të lartë sa për ta dëgjuar të gjithë.

- Besoj ta ketë përgatitur vetë ai, - ndërhyri Utsumi papritur.

- Si mund të jeni e sigurt për këtë? - pyeti Mamija.

- Sepse kemi një dëshmitar që mund ta konfirmojë, - vazhdoi Utsumi, pasi i lëshoi një vështrim Kusanagit. - Zonjusha Uakajama.

- Ah, po, çfarë po thoni në lidhje me kafënë?! - Kusanagi u mendua në lidhje me bisedën e tyre të ditës së mëparshme.

- Ju kujtohen pjatëzat? Ju kam pyetur nëse zoti Mashiba e kishte apo jo zakon të përdorte pjatëzën kur pinte kafë. Zonjusha Uakajama u përgjigj se ekzistonin mundësitë të mos e përdorte kur e pinte kafënë vetëm.

- Tani që e mendoj, e kam dëgjuar këtë bisedë shkarazi, - tha Mamija duke pohuar.

- Duke supozuar se zonjusha Uakajama nuk ka shpikur gjithçka, pyetja tani është kjo: si është e mundur që asistentja e bashkëshortes të dijë diçka mbi bashkëshortin, kur vetë bashkëshortja nuk është në dijeni të faktit?

- Besoj se duhet t'ju them diçka, - ndërhyri Kusanagi, duke u anuar përpara e duke referuar dyshimin se Hiromi Uakajama dhe Joshitaka Mashiba mund të ishin pak më tepër se dy të njohur të thjeshtë.

Mamija pa dy detektivët dhe buzëqeshi:

- E mendoni dhe ju kështu?

- Çfarë? Edhe ju e dinit komandant?

Kusanagi ngriti njëren vetull.

- Pas shumë vitesh pune në polici kam mësuar t'i dalloj gjëra të tilla. Dje kam kuptuar që kishte diçka nën rrogos.

- Hëm. A mund të ma shpjegoni se për çfarë bëhet fjalë? - pyeti Kishitani.

- Ta shpjegoj pastaj, - tha Mamija, duke u kthyer sërish nga Kusanagi. - As edhe një fjalë në sy të të shoqes, në rregull?

Kusanagi e Utsumi pohuan.

- Atëherë helmi ishte në kafënë e derdhur në tokë? - pyeti Kusanagi.

- Ishte dhe në një vend tjetër.

- Ku?

- Në filtrin e letrës në kullësë. Më saktësisht në kafënë e bluar.

- Atëherë kanë përzier kafënë me helmin gjatë kohës që e përgatisnin? - pyeti Kishitani.

- Mundet. Por ekziston dhe një mundësi tjetër, - shtoi Mamija.

- Mund ta kenë shtuar helmin në kafënë e bluar përpara se ta përgatisnin, - tha Utsumi. Mamija e pa i kënaqur.

- Pikërisht kështu. Kafja e bluar ishte në frigorifer. Ata të departamentit shkencor nuk kanë gjetur gjurmë helmi në pako, po kjo nuk do të thotë se nuk ka. Mund të ndodhë që të ketë qenë në shtresën e sipërme dhe burri ta ketë marrë me lugë.

- E, atëherë, kur mund të ketë ndodhur helmimi i kafesë?
- pyeti Kusanagi.

- Nuk e dimë. Departamenti i hetimit ka mbledhur te mbeturinat ca filtra të përdorur, por në asnjërin prej tyre nuk kishte helm. Jo se më duket e mundur, por po të ishte ashtu dikush tjetër do të kishte përdorur filtrin e kështu do të kishim dy të vdekur.

- Ishte një filxhan kafeje i palarë në lavapjatë, - tha Utsumi.
- Do doja të dija kur është pirë ajo kafë. E, sigurisht, kush e ka pirë.

Mamija njomi buzët.

- Këtë e dimë. Gjurmët përkojnë me dy persona: njëra është e Joshitaka Mashibas e tjetra është e asaj që mendoni ju.

Kusanagi e Utsumi shkëmbyen vështrimet. Me sa duket teoria e tyre kishte tashmë provat që e mbështesnin.

- Komandant, duhet t'ju informoj që zonjusha Uakajama do të vijë nga momenti në moment, - tha Kusanagi ndërsa i tregonte për telefonatën gjatë udhëtimit. Në hapësirën mes vetullave të Mamijës u krijuan dy rrudha.

- E po, mund të jetë një rast i mirë. Pyeteni kur e ka pirë atë kafënë. Dhe bëni që t'jua tregojë me detaje dhe jo konfirmime të vagullta të tipit "Oh, mund ta kem pirë një ditë më parë".

- E qartë, - tha Kusanagi.

U dëgjuan disa hapa në shkallë e dialogu u ndërpre.

- Ju falënderoj që më pritët! - tha Ajane duke hyrë në sallon. Kishte veshur një këmishë bojë qielli me pantallona të zeza. Nuk ishte më e zbehtë, si atëherë kur kishte mbërritur në aeroport, ndoshta sepse kishte sistemuar grimin.

- Nëse na siguroni që nuk jeni e lodhur, do të donim t'ju bënim disa pyetje të tjera, - tha Mamija.

- Sigurisht, si mund t'ju ndihmoj?

- Ju lutem, uluni, - komandanti bëri me shenjë për nga drejtimi i divanit. Ajane u ul ndërsa vështrimi i saj u zhvendos në kopshtin përtej dyerve të xhamit.

- Shihini se si janë fishkur, - tha. - I pata kërkuar tim shoqi t'i ujiste, po atij nuk i është bërë kurrë vonë për lulet. Duhet ta kisha marrë me mend.

Edhe Kusanagi pa drejt kopshtit. Kishte lule të ngjyrave të ndryshme nëpër vazo e në shtretërit e gjatë të luleve.

- Më falni, - tha Ajane, ndërsa bëri të ngrihej nga divani. - Mundem t'i ujis? Kam frikë se ndryshe nuk do të arrij të përqendrohem.

Mamija ngeli i shpërqendruar për një moment pastaj buzëqeshi.

- Sigurisht. Nuk e kemi me nxitim.

Gruaja u ngrit, por në vend që të shkonte drejt derës së xhamit u drejtua për nga kuzhina. Kusanagi e ndoqi me shikim teksa ishte te çezma duke u munduar të mbushte një kovë të madhe me ujë.

- Nuk keni tub uji në kopsht? - pyeti.

Ajane pa përreth e buzëqeshi.

- Kjo është për lulet e ballkonit, - tha, - nuk ka çezmë në katin e parë.

- Ah, kuptoj.

Kusanagi u kujtua që një ditë më parë kishte parë Utsumin tek vështronte vazot e luleve në ballkonin e katit të parë. Kova e mbushur dukej tepër e rëndë. Kusanagi u ofrua për ta mbajtur.

- Mos u shqetësoni, mund t'ia dal.

- Jo, me të vërtetë, më lejoni t'ju ndihmoj, - këmbënguli detektivi. - Lart nëpër shkallë, e drejtë?

- Faleminderit! - tha Ajane me një zë që mezi dëgjohej. Dhoma e gjumit nuk ishte e madhe, si salloni në katin e poshtëm, por gjithsesi mbetej e bollshme. Kusanagi nuk mundi ta mposhte dëshirën për t'u ndalur për të vështuar copat me ngjyra të gjalla të një sixhadeje muri prej *patchwork*-u të varur sipër kokës së krevatit.

- E keni bërë ju?

- Po. Kohë më parë.

- Është me të vërtetë i mrekullueshëm. Më falni për injorancën po kur dëgjova *patchwork* mendova se bëhej fjalë për diçka të thjeshtë, një lloj qëndisme. Ndërsa kjo... e po, ky është art.

- Më pëlqen ta konsideroj si art konkret. Me *patchwork* krijohen gjëra që mund të përdoren në jetën e përditshme. Përse të mos i bëjmë të bukura këto gjëra?

- Jeni me të vërtetë e talentuar. Kushedi sa mund i kushtoni.

- Në fakt të merr shumë kohë dhe kërkon njëfarë durimi. Por është ngazëlluese. E, në fakt, po të mos ishte e tillë, do të përfundoja duke krijuar gjëra që nuk janë të kënaqshme për syrin.

Kusanagi pohoi dhe vështroi dhe një herë tjetër sixhadenë e murit. Edhe pse në pamje të parë ngjyrat dukeshin si të zgjedhura rastësisht, iu duk se pa gjenialitetin e stilistes në renditjen e copave, dhe e gjithë kjo e bëri të buzëqeshte. Ballkoni shtrihej përbri gjatësisë së dhomës e ishte mjaft i bollshëm, edhe pse numri i madh i vazove ia bënte të vështirë kalimin edhe një personi të vetëm. Ajane shkoi drejt cepit dhe mori një kanoçe prej alumini.

- A nuk është e këndshme? - tha, duke ia treguar Kusanagit, ndërsa qëndronte në këmbë pranë derës prej xhami. Në fundin e kanoçes ishin hapur disa vrimëza. Ajane mori pak

ujë nga kova, e vendosi kanoçen mbi vazo dhe hodhi ujë për ta spërkatur.

- Ah! Një ujitëse artizanale.

- Pikërisht ashtu. Është e lodhshme ta kalosh ujin nga kova në ujitëse, kështu që kam bërë disa vrime në këtë kanoçe.

- Ide e mirë.

- Vërtet? Sigurisht, ai nuk e kuptonte këmbënguljen time për të mbajtur lule këtu sipër... - fytyra e Ajanes u ashpërsua dhe gruaja u përkul mbi ballkon. Uji nga kanoçja po i pikonte mbi njërën pantofël.

- Zonja Mashiba? - tha Kusanagi.

- Më falni! Vetëm se... nuk arrij ta besoj që ai nuk është më.

- Është krejt e kuptueshme që të ndiheni kështu.

- Kishim vetëm një vit që ishim martuar. Një vit. Sapo ia kisha dalë të mësohesha me jetën e re që po bëja... sapo kisha nisur të kuptoja çfarë do të thotë të jetosh në çift. Çfarë i pëlqen të hajë, çfarë ka dëshirë të pijë... Kishim bërë aq shumë plane.

Kusanagi e pa ashtu me një rëndësi të madhe mbi fytyrë, ndërsa kokën e mbante të përkulur anash. Nuk dinte çfarë të thoshte. Papritmas, lulet që e rrethonin dukeshin krejtësisht jashtë vendit.

- Më falni! - psherëtiu Ajane. - E di që kështu nuk po ju ndihmoj shumë. Duhet... duhet të mbledh veten.

- Mund të kthehemi e të vazhdojmë me pyetëtorin tonë një ditë tjetër, - tha Kusanagi pa u thelluar në mendime. Në atë çast iu duk se pa çehren e vëngërt në fytyrën e Mamijës.

- Jo, mos u shqetësoni. Edhe unë e kam të nevojshme të di se çfarë ka ndodhur. Nuk arrij me të vërtetë të kuptoj: si është e mundur që ai të ketë pirë helm?

Fjalën ia ndërpreu zilja e derës. U ngrit e alarmuar dhe pa poshtë nga ballkoni.

- Hiromi! - bërtiti ndërsa bënte shenja me dorë.

- Arriti zonjusha Uakajama? - pyeti Kusanagi.

Ajane pohoi dhe u kthye brenda.

Kusanagi e ndoqi nëpër shkallë. Utsumi ishte në korridor e po shkonte ta hapte derën. Kusanagi e arriti te hyrja dhe i pëshpëriti.

- Është Hiromi Uakajama.

Ajane i la pas të dy dhe hapi derën. Hiromi Uakajama gjendej aty përballë tyre.

- Hiromi, eja, - tha Ajane me zërin e mbytur.

- A jeni mirë, zonja Mashiba?

- Po, faleminderit...

Ajane doli në prag e përqafoi të ftuarën. Pastaj shpërtheu në lot me ngashërim, ndërsa krizat e lemezës e kishin mbërthyer si të ishte fëmijë.

Pesë

Ajane u shkëput nga Hiromi.

- Më fal, - pëshpëriti ndërsa fshinte lotët. - Mendoja se mund të isha përmbajtur, por kur të pashë... Tani jam mirë. Më fal.

Kusanagi ndjeu një shtrëngim në stomak kur pa se e veja po sforcohej të buzëqeshte. *Ka nevojë të qëndrojë vetëm.*

- Mund të bëj diçka? - pyeti Hiromi.

Ajane tundi kokën.

- Mjafton prania jote. Të them të vërtetën, për momentin nuk arrij të mendoj për asgjë. Jepi, hyr brenda. Më trego se si rrodhën ngjarjet.

- Në të vërtetë, zonja Mashiba, - e ndërpreu Kusanagi ngathët, - edhe ne kishim dëshirë të flisnim me zonjushën Uakajama. Mbrëmjen e djeshme gjithçka eci shumë shpejt dhe kanë mbetur akoma disa gjëra për t'u sqaruar.

Hiromi dukej konfuze.

- E dëgjove? Është një kënaqësi të të kemi mes nesh, - tha Ajane.

Detektivi nëpërdhëmbi me vete. *Nuk ka kuptuar asgjë.*

- Në të vërtetë do të kishim nevojë të flisnim më parë me vajzën, nëse nuk ju vjen keq.

- Por dhe unë kam nevojë të di se çfarë ka ndodhur. Kjo është arsyeja pse i kërkova të vinte këtu, - u përgjigj e habitur.

- Zonja Mashiba? - ndërhyri Mamija. Kusanagi nuk e dinte sa kohë mund të kishte komandanti që qëndronte pas tij. - Më vjen keq, të tilla janë procedurat që duhen ndjekur. Duhet të prisni që detektivi Kusanagi të flasë një herë me zonjushën Uakajama... Bëhet fjalë vetëm për të mbushur disa hapësira që na kanë ngelur të zbrazëta e të mbushin disa dokumentacione, por çështja qëndron se po nuk i bëmë gjërat si duhet mund të hasim probleme në vazhdimësi.

Një shembull klasik i policit pasiv-agresiv, mendoi Kusanagi i habitur. Ajane u ngrys.

- Në rregull. Atëherë ku duhet të shkoj unë?

- Mund të qëndroni këtu zonja Mashiba. Do të na pëlqente që pastaj të flisnim dhe me ju, - Mamija u kthye nga Kusanagi e Utsumi. - Mund të gjeni një vend të qetë për të biseduar me zonjushën Uakajama?

- Po shkoj të marr makinën.

Utsumi doli nga dera me një hap të vendosur. Njëzet minuta me pas, Kusanagi qëndronte i ulur ngjitur Utsumit në një tavolinë të veçuar, në restorant. Përballë tyre qëndronte e nervozuar Hiromi Uakajama.

- A mundët të flinit natën e shkuar? - pyeti detektivi pas një gllënjë kafeje.

- Jo dhe aq.

- Kuptoj. Duhet të keni qenë e tronditur, - kishte qenë e përlotur, nëse Utsumi e kishte parë si duhet. Nuk qëllon çdo ditë të shohësh një njeri të vdekur. Veçanërisht nëse bëhet fjalë për dashnorin tënd.

Hiromi vështronte me ngulm tavolinën, ndërsa kafshonte buzën.

- Doja t'ju pyesja mbi disa gjëra, të cilat dje nuk arritëm t'i sqaronim, nëse nuk ju vjen keq.

Hiromi mori frymë thellë.

- Në të vërtetë nuk di asgjë më tepër nga ajo që ju kam thënë. Nuk e di si do të jetë e mundur t'ju përgjigjem pyetjeve të tjera.

- Mund dhe të habiteni. Nuk bëhet fjalë për pyetje të komplikuar, për sa kohë ju jeni e gatshme të përgjigjeni me sinqeritet.

Hiromi ngriti sytë; shikimi i saj ishte i egërsuar.

- Nuk kam gënjyer.

- Mjaft mirë. Atëherë, po pyesja veten: thatë që e keni gjetur kufomën e Joshitaka Mashibës dje në orën tetë të mbrëmjes, në darkë. E drejtë?

- Po.

- Jeni e sigurt? Zonjusha Uakajama, impakti që mund të ketë të parit e një të vdekuri mund të luajë shaka të hidhura me kujtesën. Mundohuni të relaksoheni e të përqendroheni, a jeni e sigurt se nuk keni qenë në shtëpinë e Mashibave pas së premtës mbrëma?

Kusanagi studioi fytyrën e Hiromit.

Qerpikët e gjatë të vajzës u drodhën. Pas një çasti heshtjeje, rinisi të flasë.

- Përse po më pyesni? Përse ngulni këmbë me këtë pyetje, kur unë ju kam thënë të vërtetën?

Kusanagi formoi një buzëqeshje të lehtë.

- Pyetjet, nëse ma lejoni, i bëj unë. A mund të më përgjigjeni?

- Por...

- Merreni thjesht si një konfirmim, po jua kërkoj përsëri vetëm sepse dua që të reflektoni mirë mbi përgjigjen tuaj. Nëse më vonë mund të zbulohet një mospërputhje ose një

mungesë në atë që na keni thënë, mund të hasim probleme serioze për të dyja palët.

Hiromi mbylli gojën. Kuasanagit i dukej sikur mundej t'ia dëgjonte mendimet që i vlonin në kokë. *Po reflekton mbi mundësinë që mund ta demaskojmë, pyet veten mos është më mirë që të pranojë gjithçka menjëherë.* Vajza mbeti në heshtje, e lëkundur mbi vazhdimësinë e bisedës. Kusanagit po fillonte t'i sosej durimi.

- Dje, kur mbërritëm në vendin e krimit, në lavapjatë kishte një filxhan kafeje dhe dy pjatëza. Kur ju pyetëm mbi arsyen pse ato objekte ishin aty, ju thatë që nuk e dinit. Ama në filxhan gjetëm gjurmët tuaja digjitale. Kështu që më erdhi spontane t'ju pyes: kur e keni prekur filxhanin?

Shpatullat e Hiromit uleshin e ngriheshin ngadalë në bazë të ritmit të frymëmarrjes së saj.

- Jeni takuar me Joshitaka Mashibën këtë fundjavë, apo nuk është kështu? Atëherë kur ishte akoma i gjallë.

Hiromi çoi njëren dorë në ballë ndërsa mbështeti bërrylin mbi tavolinë. *Tani dua të shoh se çfarë përgjigje do të më japë.* Kusanagi ishte i sigurt se vajza nuk do t'ia dilte t'i shmangej, sado ta provonte. Hiromi pohoi, duke ndjekur me shikim dorën që i zbriste në tavolinë.

- Po, është e vërtetë, më falni.

- Jeni takuar me zotin Mashiba?

Bëri një pushim e pastaj:

- Po.

- Kur?

Përgjigjja vonoi të vinte. *Nuk është një humbëse e mirë,* - mendoi Kusanagi duke u nervozuar.

- A është e detyrueshme të përgjigjem? - Hiromi e drejtoi shikimin për nga dy detektivët. - Nuk ka të bëjë aspak me atë që ka ndodhur. A nuk është ky një dhunim i privatësisë?

Dukej sikur ishte në pikën që do të niste të qante, por nga sytë e saj përçohesh zemërim e fjalët ishin shndërruar në të ashpra. Kusanagit i erdhën ndër mend fjalët që i kishte thënë një tjetër detektiv: “Sado që mund të të duket e pambrojtur, mos e nënvlerëso kurrë fuqinë e një femre që gënjen”. Nuk kishte mbetur më kohë për ta marrë situatën me butësi. Kusanagi luajti me kartën e radhës.

- E dimë shkakun e vdekjes, - tha ngadalë, - zoti Mashiba është helmuar nga dikush.

Hiromi bërtiti.

- Çfarë?

- Janë gjetur gjurmë helmi në kafënë që po pinte përpara se të vdiste.

Vajza çapëloi sytë.

- Nuk e kuptoj sesi... është e pamundur!

Kusanagi u anua lehtë përpara me vështrimin e ngulitur në të sajën.

- Përse?

- Sepse...

- Sepse kur ju patët pirë kafënë bashkë me të më herët nuk pati ndodhur asgjë e çuditshme?

Hiromi puliti sytë. Pastaj pas një çasti ku mbeti e përhumur, pohoi ngadalë.

- E kuptoni se cili është problemi ynë, zonjusha Uakajama. Nëse ka qenë zoti Mashiba personi që e ka hedhur helmin në filxhan është njëri rast: mund të bëhet fjalë për një vetëvrasje ose një aksident. Por ka shumë pak mundësi që të bëhet fjalë për ndonjërin prej këtyre opsioneve. Na mbetet vetëm të aludojmë që dikush ka helmuar kafënë e zotit Mashiba. Janë gjetur gjurmë të helmit edhe në një filtër të përdorur.

Për momentin hipoteza jonë mbështetet te rasti se dikush ka hedhur helm në kafënë e bluar.

Dukshëm e tronditur, Hiromi shkundi kokën.

- Unë nuk di asgjë.

- Por, sigurisht, që keni mundësi t'iu përgjigjeni disa prej pyetjeve tona. Për ne është ekstremisht e rëndësishme të dimë se pikërisht kur e keni pirë kafënë në shtëpinë e Mashibave, për të vendosur se kur është hedhur helmi në pluhur. Atëherë?

Kusanagi u drejtua në karrige duke fiksuar me shikim të përqendruar vajzën nga ana tjetër e tavolinës, i gatshëm për të dëgjuar në heshtje gjithçka që ajo kishte për të thënë. Hiromi mbuloi gojën me duar. Sytë e saj lëviznin në mënyrë të çrregullt. Pastaj, papritmas tha:

- Nuk e kam bërë unë.

- Si?

- Nuk e kam bërë unë, - zëri i saj ishte shndërruar në një zë lutës. Shkundi kokën: - Nuk e hodha unë helmin në kafë. Po ju them të vërtetën. Duhet të më besoni.

Kusanagi e Utsumi shkëmbyen një shikim. Hiromi Uakajama ishte pjesë e të dyshuarve, sigurisht, në fakt ishte më e mundshmeja ndër ta. Kishte pasur më shumë se një shans për të hedhur helm në kafë. Nëse kishte një marrëdhënie me Joshitaka Mashibën, nuk ishte e vështirë që një përplasje mes të dyve të ishte zgjidhur edhe në atë mënyrë. Ndoshta, ta helmonte e pastaj të “zbulonte” kufomën, ky kishte qenë plani për të maskuar rolin e saj në këtë çështje. Në këtë fazë, ama, Kusanagi dëshironte të evitonte çdo zgjidhje që mund të merrej si e mirëqenë dhe kërkonte të merrte prej saj një version të historisë, sa më spontan që të ishte e mundur. Kishte kërkuar qëllimisht të mos thoshte asgjë që mund të

tingëllonte si akuzuese. E kishte pyetur vetëm se kur e kishte pirë kafënë me Joshitaka Mashibën. Përse, atëherë, ajo vajzë ishte deklaruar menjëherë si e pafajshme? Përse në të vërtetë ishte e fajshme? Ose përse kishte vetëm hamendësuar se ku mund ta çonte e gjitha kjo?

- Nuk po ju akuzojmë që e keni helmuar, - tha Kusanagi me një buzëqeshje të ëmbël. - Si thashë edhe më herët, thjesht po mundohemi të stabilizojmë versionet. Nëse jeni takuar me zotin Mashiba për të pirë një kafë, atëherë mund të na tregoni se kur ka ndodhur kjo, kush e përgatiti kafënë dhe si kanë rrjedhur ngjarjet me përpikëri.

Fytyra e zbehtë e Hiromit mori një pamje të përvuajtur. Kusanagi nuk arrinte të kuptonte, nëse ajo hezitonte sepse nuk donte të pranonte që kishte një marrëdhënie me burrin, apo kishte ndonjë arsye tjetër.

- Zonjusha Uakajama? - ndërhyri Utsumi ashpërsisht.

Hiromi ngriti shikimin e alarmuar.

- Ne tashmë e kemi krijuar idenë e raportit që kishit ju me Joshitaka Mashibën, - vijoi detektivja me ftohtësinë e një nëpunësi shtetëror, që jep udhëzime për të mbushur një formular, - mund ta mohoni nëse keni dëshirë. Nëse i tillë është rasti, dëshirojmë t'ju bëjmë pyetje të tjera për të kuptuar cila është e vërteta. Zakonisht, edhe pse na kushton pak mund, ia dalim të zbulojmë gjithçka..., por për ta bërë këtë, do të jemi të detyruar të flasim me një numër të madh njerëzish. Kuptoni? Do të doja që të reflektoni mbi atë që thashë. Nëse ia dilni të jeni me të vërtetë e sinqertë me ne, mund të jemi më të kujdesshëm me investigimet tona. Supozojmë, për shembull, që ju dëshironi të na thoni diçka që, mundësisht, do të donit të mbetej brenda mureve të zyrës sonë.

Utsumi i shigjetoj një vështrim Kusanagit dhe përkuli paksa kokën.

Është mënyra e saj për të kërkuar falje nëse ka folur pa takt? Kusanagi po pyeste veten. Sidoqoftë, këshilla e saj u duk se pati një ndikim të dukshëm te Hiromi. Ndoshta ishte më e lehtë kur dëgjohej nga goja e një femre. Vajza uli për një moment kokën, pastaj e ngriti dhe u mbush me frymë.

- Më premtoni që nuk do ia thoni askujt?

- Vetëm nëse janë të lidhura drejtpërdrejt me rastin, informacionet personale nuk i ndajmë kurrë me të tjerët. Është procedura standarde, - shpjegoi Kusanagi.

Hiromi pohoi.

- Atëherë... Ashtu si dyshoni, në fakt unë dhe zoti Mashiba kishim një... lidhje. Po, kam shkuar ta takoj në fundjavë.

- Pikërisht kur?

- Të shtunën mbrëma. Pak pasi kishte kaluar ora nëntë, më duket.

Takohen kur bashkëshortja nuk është vërdallë, atëherë.

- A ishte diçka e planifikuar?

- Jo, më telefonoi në punë, sapo kisha mbaruar mësimin, ndërsa isha duke sistemuar sallën. Më ftoi të shkoja tek ai.

- Dhe kështu ju shkua tek ai. Çfarë ndodhi më pas?

Hiromi u mendua për një çast, pastaj, më e vendosur pa nga Kusanagi.

- Kalova natën me të dhe mëngjesin e nesërm u largova.

Utsumi kishte filluar të merrte shënime. Kusanagi i lëshoi një vështrim, por nuk mundi të lexonte asgjë nga shprehia e saj. *Ka nuhatur diçka*, - mendoi, duke i premtuar vetes që do ta pyeste pastaj.

- Kur e keni pirë kafënë bashkë?

- Në mëngjes. E përgatita unë. Ah jo, e kemi pirë dhe natën e shkuar.

- Të shtunën mbrëma? Domethënë keni pirë dy herë kafë?

- Po.

- E përgatitët ju dhe natën e shkuar?

- Jo. Zoti Mashiba e kishte përgatitur tashmë në momentin që mbërrita unë. Mbushi nga një filxhan për të dy, - vazhdoi Hiromi duke ulur shikimin. - Ishte hera e parë që e shihja të përgatiste kafenë. “Ka kaluar disa kohë nga hera e fundit që e kam përgatitur”, - më tha.

- Dhe nuk përdorët pjatëza atë mbrëmje? - pyeti Utsumi ndërsa ngrinte shikimin nga blloku i shënimeve.

- Jo, - konfirmoi Hiromi.

- Ama kafenë e mëngjesit të ditës së nesërme e përgatitët ju, domethënë dje në mëngjes? - pyeti Kusanagi.

- Kafeja e zotit Mashiba ishte tepër e fortë, kështu që në mëngjes më pyeti nëse mund ta përgatisja unë. Ndenji aty ndërsa më shihte tek e përgatisja, - ngriti shikimin tek Utsumi. - Atë radhë i përdorëm pjatëzat, ato që gjetët në lavapjatë.

Kusanagi pohoi. Deri tani historia e saj nuk kishte asnjë mangësi.

- Dhe diçka, sa për siguri: si të shtunën mbrëma, ashtu dhe të dielën në mëngjes, keni përdorur të njëjtën kafë të bluar, atë që gjetët në shtëpi?

- Besoj se po. Të paktën kur e përgatita unë, përdora kafenë që gjeta në frigorifer. Nuk e di nëse ka vepruar njësoj dhe zoti Mashiba të shtunën mbrëma, por nuk shoh asnjë arsye pse mund të ketë përdorur tjetër kafë. Kishte me bollëk.

- Keni përgatitur kafë herë tjetër në shtëpinë e Mashibave, më herët se këtë fundjavë?

- Rrallëherë, kur ma kërkonte Ajane. Ishte pikërisht ajo që më mësoi ta përgatisja pa makinët. Kjo ishte arsyeja pse dija ta përgatisja.

- Vutë re ndonjë gjë të çuditshme ndërsa përgatisnit kafenë? A ishte pakoja në vendin e vet të zakonshëm, apo kishte ndërruar vend? A ishte e njëjta markë?

Hiromi mbylli ngadalë sytë e tundi kokën.

- Nuk më kujtohet asgjë e çuditshme. Ishte si zakonisht, - kur i hapi, në sytë e saj u shfaq një nuancë kurioziteti. - Po nuk arrij të kuptoj pse ju intereson aq shumë se si ishin gjërat kur përgatita kafenë.

- E pse jo?

- E po, sepse... - uli fytyrën, por pa e hequr shikim prej tyre. - Nuk kishte helm në kafë kur e përgatita unë, e drejtë? Nëse dikush e ka helmuar kafenë duhet ta ketë bërë pasi e pata përgatitur unë.

- E vërtetë, vetëm nëse është bërë me ndonjë marifet, ndonjë metodë që e ndryshon kafenë më herët.

- Një marifet? - Hiromi nuk dukej aq e bindur. - E po, unë nuk kam vënë re asgjë të çuditshme.

- Atëherë, atë mëngjes ju e pitë kafenë bashkë. Po pastaj?

- U largova. Jap mësimet *patchwork*-u në një shkollë arti në Ikebukuro.

- Në çfarë ore keni mësim?

- Atëherë, në mëngjes nga ora nëntë deri në njëmbëdhjetë, ndërsa pasdite nga ora tre deri në gjashtë.

- Çfarë bëni ndërmjet orëve të mësimit?

- Zakonisht sistemoj sallën, drekoj dhe përgatitem për leksionin e radhës.

- E merrni drekën me vete nga shtëpia?

- Jo gjithmonë. Dje dola dhe hëngra në një *Noodle Bar* në rrethina... - mbylli sytë. - Besoj se kam ndenjur larg shkollës për rreth një orë. Edhe po të kisha dashur nuk do ia kisha dalë të shkoja e të kthehesha nga shtëpia e Mashibave.

Kusanagi u zgërdhi e shkundi njëren dorë.

- Mos u shqetësoni, nuk jemi duke kontrolluar alibinë tuaj. Duke qëndruar tek ajo që na thatë dje, ju i keni telefonuar zoti Mashiba sapo keni mbaruar mësimin. Dëshironi të korrigjoni konfirmimin tuaj në ndonjë mënyrë?

Hiromi ngriu dhe hodhi shikimin diku tjetër.

- E kam telefonuar, është e vërtetë. Ama e kam bërë këtë për një arsye tjetër nga ajo që ju thashë.

- Nëse nuk gaboj ju thatë që dëshironit të dinit se si po ia çonte ai pa të shoqen.

- Në të vërtetë, kur isha duke u larguar, atë mëngjes, më kërkoi që ta telefonoja pas mësimit. Kusanagi e pa.

- Ju ftoi për të dalë në darkë me të, vërtetë?

- Po, besoj se ajo ishte ideja.

- E po, ndershmërisht, tanimë më duket e gjitha më e qartë. Vetëm një studente ekstremisht e devotshme do të shqetësohej aq shumë për bashkëshortin e mësueses së saj, dhe vetëm një njeri tmerrësisht i ndjeshëm do të shkonte në shtëpinë e dikujt vetëm sepse ky i fundit nuk i është përgjigjur në telefon.

Shpatullat e Hiromit u harkuan.

- Kisha frikë se mos ngjante e dyshimtë. Gjithsesi nuk dija se çfarë mund të thosha tjetër.

- Zoti Mashiba nuk ju përgjigj në telefon, kështu që ju shkuat në shtëpinë e tij. E konfirmoni deklaratën tuaj?

- Po. E gjithë pjesa tjetër ka shkuar ashtu si ju kam thënë. Më falni që ju gënjeva.

Pranë Kusanagit, Utsumi po merrte shënime në mënyrë frenetike. Detektivi i hodhi një vështrim përpara se të kthehej nga Hiromi. Deri në atë pikë historia e saj tingëllonte e besueshme. Gjithë dyshimet e mbrëmjes së shkuar ishin venitur. Gjithsesi kjo nuk mjaftonte për të besuar verbërisht tek ajo.

- Si ju thashë, jemi thuajse të bindur se bëhet fjalë për një vrasje. Nëse nuk gaboj, mbrëmë ju pyeta nëse mund të kishit ndonjë ide se kush mund ta kishte bërë. Më thatë që jo, që nuk dinit asgjë për të ndjerin, përveç faktit se ishte bashkëshorti i mësueses suaj. A keni diçka për të shtuar, meqë tani jemi në dijeni të lidhjes suaj me të?

Hiromi harkoi vetullat.

- Nuk kam asnjë ide se kush mund të ketë qenë. Nuk më vjen në mendje askush që mund të ketë dashur të vrasë Joshitakën.

Kusanagi vërejti kalimin nga emërtimi “zoti Mashiba” te “Joshitaka”.

- Mundohuni të riktheni bisedat e mëvonshme. Nëse bëhet fjalë për një vrasje, është e sigurt që është me paramendim. Kjo do të thotë që është një shënjestër precize, dhe në shumicën e rasteve, viktima është në dijeni. Edhe nëse është munduar ta fshehtë, mund t’i ketë shpëtuar diçka.

Hiromi fërkojti tëmthat dhe tundi kokën.

- Nuk e di. Dukej sikur puna i shkonte mirë, nuk kishte shqetësime të mëdha dhe nuk fliste kurrë keq për asnjeri.

- Ju lutem, merrni pak më tepër kohë për t’u menduar.

Vajza e pa Kusanagin me sy të trishtuar.

- E kam menduar. Kam kaluar gjithë natën duke qarë ndërsa pyesja veten sesi ndodhi. Kam menduar e rimenduar gjithçka që kemi thënë, gjithçka që kemi bërë. Por asgjë.

Detektiv, edhe unë kam nevojë të di pse e vranë. Dua ta di më shumë se gjithçka tjetër në botë.

Kusanagi vërejti një skuqje rreth rrahëve të syve të saj. *E paska dashur me të vërtetë*, - mendoi Kusanagi. Ama nëse shtiret, është me të vërtetë e zonja.

- Kur pati nisur marrëdhënia juaj me zotin Mashiba?

Hiromi zgurdulloi sytë.

- Çfarë lidhje ka kjo me rastin?

- Na takon ne të vendosim nëse ka lidhje, apo jo. Ju përsëris se gjithçka thamë do të mbetet mes nesh e në momentin që do të kuptojmë se e gjitha kjo nuk ka lidhje me çështjen, nuk do t'i fusim më hundët në punët tuaja.

Buzët e Hiromit skicuan një vijë horizontale. Mori frymë thellë, zgjati dorën e piu një gllënjë nga çaji i saj.

- Rreth tre muaj më parë.

- Faleminderit! - Kusanagi uli vështrimin, duke pyetur veten se në çfarë mënyre do të mund të vazhdonte të bënte pyetje mbi çështjen. - A ka ndonjë tjetër që është në dijeni?

- Me sa di unë, jo.

- A keni dalë për darkë herë të tjera? Mund t'ju ketë parë dikush.

- Ishim shumë të kujdesshëm. Nuk kemi shkuar kurrë dy herë në të njëjtin vend. Joshitaka kishte shpesh darka pune me gratë, ose me *hostes* të bareve, kështu që nuk besoj se dikush mund të ketë dyshuar, edhe nëse na kanë parë bashkë.

E kështu Joshitaka Mashiba ishte një tip *playboy*. Kusanagi pyeti veten nëse ai kishte pasur dashnore të tjera përveç zonjushës Uakajama. Kjo, sigurisht, do t'i kishte dhënë një motiv gruas së ulur përballë tij. Utsumi u ndal së shkruari për një moment dhe ngriti shikimin.